

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVIII i botimit, nr. 211, Maj 2021  
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## DUKAGJINI KESHTJELLË QËNDRESE DHE KRENARIE KOMBËTARE

2

Nga, Agron Prebibaj

Jo shumë larg por diku permby Drin në preherin e alpeve shqiptare ndodhet krahina e krenarisë kombëtare, një emër i njohur për secilin bashkëkombas në trojet e veta e kudo që shqiptaret jetojnë.

Ngacmuesi im për të shkruajtur ishte intelektual i dukagjinasi Prof. Prele Shytani i cili në një kafe më tha, përse nuk ke shkruajtur për Dukagjinin? Unë menjëherë ju pergjigja - po, duke i thenë se keni të drejtë, kam shkruar ndër vite por unë jua kam borgj si pjesë e saj për nga traditat e zakonet e familjes time, megjithëse me gjenëzë nga Malësia e Gjakoves.

Mesa duket emeri Dukagjin është pagëzuar nga vetë Zoti kur Ai foli njeherë shqip për të ofruar të gjitha mrekullite që nga deti e deri te kjo tokë e bekuar ...



## MARTINAJT E TROPOJËS NË NEW YORK E PINJOLLI LUSH PEPA (Luçiano)

Pak histori për shtëpinë  
e Ndre e Balë Prekës, Curraj

Kur kalon nga Qafa e Kolçit e zbret për në Nikaj-Mertur, çdo udhëtar i dalin para sysh pamje përrallore në çdo stinë: majat e larta e kreshtat e maleve shumicën e kohës të zbardhura me borë, pyjet e paanë të rritura shumë vitet e fundit, rupert e livadhet e gjelbëruara, prozhet me lajthi e kashnjetet me gështenja e arra, pemëtoret e vreshtat, diku - diku të qëndisura për bukuri nga banoret vendas, e të tjera të përkeqësua e të braktisura nga lëvizjet masive të popullsisë.

6

## ZEF MALA, PËR GJERGJ FISHTEN DHE G JUHËN SHQIPE (VITI 1955)

Për këtë aktivitet të vjetër pata marrë nga regjimi i kohës, dënime të shumta me burgime e internime duke pësuar edhe gjymtime fizike të randa. Mbas vitit '41 e mbas kthimit tim në Shqipëri i kam ndejë larg çdo veprimtari politike e shoqërore dukë u tërheqë në një kohë studimesh e meditacioni, me gjithë ftesat që më qenë ba nga Partia Komuniste për t'u integruar në të dhe për të marrë funksione përgjegjësie në organet e pushtetit të ri. Për këtë qëndrim qeshë edhe akuzue e goditë për obstruksionizëm ndaj sistemit në fuqi, bile edhe në vitin 1953 para ultimatimit me zgjedhë midis përgjegjësive dhe luftës së pashtrur që do të më bënte nga ana e partisë, i preferova t'i përbr...

14

## UNIONI "MIRDITA" - DEGA SHKODËR 3 FESTON 5 VJETORIN E KRIJIMIT

U bënë 5 vite nga dita, kur dhjetë intelektualë mirditorë, themeluan shoqatën "Mirdita", e cila ka homologët e saj në Rrëshen e në Lezhë, dhe të gjitha së bashku tashmë janë degë të Unionit "Mirdita" në Tiranë.

Në fakt, përpjekjet për ta ngritur Shoqatën, u bënë qysh në vitin 1993, por ajo nuk arriti të mbijetonte. Vetëm me 2 Maj 2016, Shoqata mori jetë, dhe sot janë anëtarësuar pranë saj rreth 200 mirditorë.



# DUKAGJINI KESHT JELLË QËNDRESE DHE KRENARIE KOMBËTARE



Nga, Agron Prebibaj

Jo shumë larg por diku permby Drin në preherin e alpeve shqiptare ndodhet krahina e krenarisë kombëtare, një emër i njohur për secilin bashkëkombas në trojet e veta e kudo që shqiptaret jetojnë.

Ngacmuesi im për të shkruajtur ishte intelektual dukagjinasi Profesor Prele Shytani i cili në një kafe më tha, përse nuk ke shkruajtur për Dukagjinin? Unë menjëherë ju pergjigja- po, duke i thenë se keni të drejtë, kam shkruar ndër vite por unë jua kam borgj si pjesë e saj për nga traditat e zakonet e familjes time, megjithëse me gjenëzë nga Malësia e Gjakoves.

Mesa duket emeri Dukagjin është pagëzuar nga vetë Zoti kur Ai foli njeherë shqip për të ofruar të gjitha mrekullite që nga deti e deri te kjo tokë e bekuar dardane më qëndresetare, besnike për të mbartur e trashëguar veset, traditat, zakonet e vrytytet më të mira, për të shëruar kombin e vet kur ai plagoset.

Vërtetë Shqipëria ndër shekuj është plagosur shpesh, është tulatur, është t'kurrur, ka ndryshuar besim fetar e perulje ndaj së keqes, por sherbesat e referencat si Dukagjini na kanë shpetuar në identitetin tonë kombëtar për të mos u përlur asnjëherë përballë çdo lloj stuhie pushtuese edhe përse shpeshëherë me kosto të madhe njerëzore.

Ne fakt Dukagjini nuk është qytet, por pasuron qyteterimin shqiptar duke sjellur shumë histori dhe ajo çfarë befason është kultura e mëshiruar në ato alpe të thyera, mbi krye Bjeshkët e Namuna për të cilat gojetaret dukagjinasi kanë pasuruar visaret e kombit.

Askund më shumë se në Dukagjin e në krahinat rrotull Zoti nuk foli më mirë shqip, bash aty pikturoi me mire, krijoi njeriun e forte, qëndrestarë, besnik e human për të parakaluar kombe të mëdha si një referencë e shkëlqyer për studiuesit.

## DUKAGJINI I SHKOLLËS SË ASHPER DHE DIJES

Nuk mund te thuhet assesi se Dukagjinasi parakalon kulturën Shkodrane (pjesë e saj) apo kulturen Korçare, pasi mundësitë për muzikën, artin e shkollimin ishin larg, porse kemi një ndryshim mes kulturës e dijes për mbijetesë.

Pa patur qellim matje mes qyteterimit e dijes, kur në djepin e kultures shqiptare Shkoder apo Korçe këndohej e kërcëhej në pape, atje në Dukagjin këndohej për kombin me dy-tre vegla muzikore (lahuta, fyelli e çiftelia), kur në djepin e kulturës shkruhej e lexohej, në Dukagjin shkolla ishte ne soben (oden) e burrave ku i madhi fliste për rregulla, për mbijetesën e humanizmin, kur në djepin e kultures nën dhoma te mbyllura, atje ne Dukagjinin e jetës së ashpër ekzistonte oxhaku për të terhequr tymin e blozen, kur në djepet e kultures shtepitë ishin me qerpiqe, atje në Dukagjin shtepitë ishin kulla guri, kur djepi i kultures pajtohej me pushtuesin, dukagjinasi zgjohej në mbrojtje të treves së vet e për t'u bërë çlirimtare i qytetit të kulturës.

Pra një ndryshim mjaft i madh mes qytetit të kulturës së dorëzuar me kalorësin dukagjinasi i cili nuk njeh kompromis për trojet shqiptare. Siç duket dukagjinasi mbeten pas se nuk njohen kabarete,



por ata në maje të maleve të ashpra i ofruan Shkodres së krenarisë tonë kombëtare, artistë e intelektualë gati sa vetë Shkodra.

Nuk desha aspak të ngre e të mati Dukagjinin përballë references sime Shkoder apo Korçe madje duhet veçuar se këta qytetarët janë më me kulturë të të gjitha hapsirave, ndërsa dukagjinasi janë krenaria e qendresës kombëtare, por të dyja së bashku formojnë shqiptonjen, një kombinim i kulturës e dijes për rezistencë.

## DUKAGJINI ELITE KOMBËTARE

Etja për dije e dukagjinasi e ka zanafillen nepermjet gojedhenave duke i trashëguar ato tek brezat, pasi edhe kombi ynë në tëresi edhe përse i lashte, i zgjuar shumë vonë për nga e shkruajtura dhe lexuara megjithëse ata kishin privilegjin nepermjet shkollave të Juzoiteve të krijonin potenciale intelektuale me dituri,

shkrim dhe lexim, shume me perpara se zona moqalore apo fusharake.

Pa ju futur thelle shkollimit nga institucionet kishtare ku u arsimuan me dhjetra burra me duhet te veçoj eliten e qytetarise shkodrane të lindur në Dukagjin të cilët ngriten lart jo vetem kulturën shkodrane e asaj kombëtare përmes personaliteteve të njohura kombëtare dukagjinase si: Ernest Koliqi, Martin Camaj, Frederik Rreshpja, Primo Shllaku, Ledio Dushi, Daniel Gjeçaj, Paulin Selimi, Gac Çuni e deri te shkrimtari i njohur shqiptar Z. Lazer Stani e plot të tjerë.

Për t'u veçuar si krenaria dukagjinase është Kardinali i pare shqiptar Mikel Koliqi i emeruar nga Papa Gjon Pali.

Ndërsa aktorët e famshem te permasave kombetare si, Pjeter Gjoka, Ndreke Luca, Tinka Kurti, Viktor Bruçeti, Lec Shllaku të pasuar nga Katrina Biga, Frederik e Rita Ndoci, Bruno Shllaku etj, njëkohësisht shumë të pasur në sport në arenën kombetare e nderkombetare. Kjo

me arsim perkates; Prele Shytani-Gimaj, Pjeter Smakaj-Abat, Mirash Ndrezej (Lotaj-Vuksanaj), Fran Dardha-Toplane, Ymer Sterniqi-Kir, Tef Topalli-Plan të cilit gjysma nuk jetojnë.

Pas hapjes së shkollës së mesme në 1972 në Breglumi, Dukagjini tashmë filon ngritjen më të lartë të elitës për t'u përfaqësuar denjesisht në Universitete e për të arritur majat e shkences shqipetare e me larg me profesor e intelektuale ne sherbim te kombit, për t'u nderuar mbetet drejtori i shkolles se mesme Prele Grima i cili mund të shënohet si personaliteti i pare i mirëshkolluar ne altarin e dijes. Me shume ngulje profesor Prele Shytani më referon mesuesit nga të gjitha shkollat e Dukagjinit porse unë në qellimin tim nuk kisha emrat por formen e persosjen e arsimit dukagjinasi pa menjëherë disa nga emrat; Lazer e Zef Fusha-Shale, Mirash e Ndue Ndrezej, Ndue Pal Vata, Fran Dardha, Fran e Kole Cardaku, Lena Fusha, Luigj Shyti, Zef Bari, Ndoc Grima, Kole Gjoka, Lulash Ndoci, Ndue e Pashka Shytani, Pal Kroni, Prele Bregu etj.

Në Pult, Pjeter Selmi, Ndoc Odri, Tereze Brigja, Gjovalin Kodra, Pashko Arra, Ndue Straga, e plot te tjerë por për të perfunduar ne Shosh me pinjollin e nje familje dukagjinase me profesorin Prekë Vuksani i ndarë nga jeta, si dhe prosorët Lazër Kodra, Prel Milani që të dy poet e shkrimtarë profesionit.

Por edhe muzika e përdorur edhe e kënduar mjeshterisht nga artistet dukagjinasi në shekuj e sot është një shëmbëlltë e kristalte.

Sikurse nuk mund të shmangem pa përmendur personalitetet me aktivitet politikokombetare si, Mark Lula-anetar i Lidhjes se Prizrenit, Mehmet Shpendi, Prof.Kole Praela e deri tek deputeti dukagjinasi i zgjedhur dy herë në sistemin demokratik Kole Tonaj, sigurisht edhe plotë të tjerë duke vendosur të heq me dhjetëra emra të referuara nga prof. Shytani. Duke lene shume gjëra

pa thenë, duke i hequr pjeserisht merakun prof.Preles i cili më kryqezoi me shumë fakte e emra të cilet ja pjestova me dy, me bindje se do rikthehem perseri në Dukagjinin tim te dashur si krenaria e Malesise time.

Vetëm atje në Dukagjin e në krahinat rrotull fryn era e veriut të Naimit te madh, vetëm nga Dukagjini vjen frymezimi i nacionalizmit të shëndoshë kombetare, vetem nga atje buron dashuria e pastër njerëzore, askund më mirë se ne Dukagjin nuk janë mjellur ndjenjat per liri e besimi në Zot. Vertete krenari te jesh dukagjinasi me familje te shëjtë të cilët përcjellin te brezat historine, kulturën, traditat e zakonet një frymezim e sherbesë për secilin bashkëkombas.

Zoti e bekoftë secilen familje dukagjinase!

# UNIONI "MIRDITA" - DEGA SHKODËR FESTON 5 VJETORIN E KRIJIMIT

U bënë 5 vite nga dita, kur dhjetë intelektualë mirditorë, themeluan shoqatën "Mirdita", e cila ka homologët e saj në Rrëshen e në Lezhë, dhe të gjitha së bashku tashmë janë degë të Unionit "Mirdita" në Tiranë.

Në fakt, përpjekjet për ta ngritur Shoqatën, u bënë qysh në vitin 1993, por ajo nuk arriti të mbijetonte. Vetëm me 2 Maj 2016, Shoqata mori jetë, dhe sot janë anëtarësuar pranë saj rreth 200 mirditorë.

Mirdita dhe Shkodra kanë lidhje të hershme mes tyre. Me pak kërkim në histori, do të mësohesh për origjinën e shumë personaliteteve, të cilët dhanë shumë në historinë shqiptare, për fe e Atdhe, për art e për dije, si: Pashko Vasa, Gjergj Fishta, Atë Prend Doçi, Ndre dhe Lazër Mjeda, Tuk e Kolë Jakova, Preng Jakova, Pjetër Gaci, Mark Kaftalli, Gjon Kapedani, Alfred Kaçinari, Bik Ndoja, Luçie Miloti, Marie Kraja, Roza Xhuxha, e të tjera.

Në një shkrim të tij për Mirditën, prof. dok. Lisen Bashkurti shkruan: **"Mirdita është vendi që mban emrin e arbërve, njerëz me zemër të bardhë, me mendje të bardhë, me veshje të bardhë, me shpirt të bardhë, me kostum të bardhë. Nëse jemi këta që jemi, jemi se kemi Mirditën; nëse jemi ata që duhet të jemi, jemi nëse e ruajmë Mirditën!"**

Askush nuk do ta kishte besuar që në Shkodër ka kaq shumë mirditorë, nëse nuk do të ishte dëshmuar kjo, jo thjeshtë me hulumtime në gjendjen civile të Bashkisë, por në unitetin që kanë pasur dhe kanë mirditorët në aktivitetet e organizuara përgjatë pesë viteve.

Mirditorët kanë familjet e tyre, e brezat kanë se çfarë tu lënë brezave: Ruajtjen e vlerave, kulturës, traditave dhe historisë së Mirditës. E një kontribut të vyer në këtë drejtim, ka dhënë edhe Shoqata "Mirdita", e cila këto tipare i ktheu në misionin e saj përgjatë 5 viteve, larg bindjeve partiake, apo ndarjes në krahina e bajoraqe, që fusin ndasi e përçarje.

Aktiviteti i Festimit të 5 Vjetorit të Degës së Unionit "Mirdita" në Shkodër, u organizua në mjediset e Bar-restorant "Oborri shkodran", në prani të mjaft mirditorëve, jo vetëm të atyre që banojnë prej vitesh në qytetin e Shkodrës, por edhe mjaft miqve e të ftuar. Nderuan me pjesëmarrjen e tyre: Familjarët e të ndjerëve



Ndue Gjonit, Preng Zefit, Pjetër Dodës dhe Gjon Markut, të cilët ishin pjesë e themelimit të Shoqatës; Anëtar i Bordit të Unionit "Mirdita" në Tiranë, zoti Gjon Lleshaj; Drejtori ekzekutiv i Unionit zoti Julian Vlasi; Kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" zoti Ndue Sanaj; Kryetari i Shoqatës "Kastrioti" në Lezhë zoti Pashk Ndoci; ish deputeti i Parlamentit shqiptar zoti Petrit Gjoni; publicisti i njohur i Qendrës Kulturore Mirditë zoti Gjergj Marku; Kryetarët e Shoqatave homologe në Mirditë dhe Lezhë; Mjeshtri i Madh Gjon Frroku, e të tjerë.

Fjala e hapjes së aktivitetit u mbajt nga

Kryetari i Degës së Unionit "Mirdita" në Shkodër, Mjeshtri i Madh, ing. Zef Gjini, i cili evidentoi ecurinë e Shoqatës, duke vendosur theksin tek mbështetja e madhe që duhet t'i jepet degës së Shkodrës nga qendra e Unionit në Tiranë. Njëherësh ai parashtroi edhe projektet për të ardhmen e afërt e të largët.

Në vijim, zoti Ndue Marku, sekretar i Degës së Shkodrës, paraqiti një panoramë të plotë të të gjithë veprimtarive të Shoqatës, që nga themelimi i saj e deri sot.

Duke vlerësuar gjithë përpjekjet e bëra deri tani dhe përgëzuar Degën e Shkodrës për organizimet serioze ndër vite, miqtë

dhe të ftuarit në aktivitet, e konsideruan Degën e Unionit "Mirdita" në Shkodër, si një model i mirë që duhet marrë shembull nga degët e tjera në Shqipëri.

Një moment i rëndësishëm ishte shpërndarja e "Çertifikatave të Mirënjohjes" për të gjithë ata mirditorë, që kanë kontribuar në mbarëvajtjen e veprimtarive në aspektin intelektual dhe profesional.

Një falenderim i veçantë shkoi për sponsorët e aktiviteteve përgjatë 5 viteve: zotin Nikolin Jakaj, kryetar i Unionit "Mirdita"; biznesmenin z. Ferdinand Melgusha, Nënkryetar i Degës së Shkodrës; avokatin Ardian Brunga; si dhe zotërinjtë Mark Gjeci, Ndue Bidani, Gjon Preçi, Dedë Marku, Shtjefën Pjetrani, Tom Pjetrani, Luigj Paloka, Ardian Lleshi, "Big Market" dhe zotin Pashk Ndoci dhe Ndue Sanaj (Kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini").

Pas karakterit zyrtar të aktivitetit, atmosfera u elektrizua nga interpretimet e mrekullueshme të këngëtarëve të Ansambllit "Treva", Ndue Shytani dhe Fran Kodra, si dhe Mjeshtrit të Madh Gjon Frroku, një nga moderatorët më të mirë të aktiviteteve të fund vitit të realizuar nga Dega e Unionit "Mirdita" për Shkodrën. Vallet dhe këngët zgjuan akoma më tepër dëshirën e mirditorëve, për të mos harruar traditat e kulturën e vendit ku u lindën dhe u rritën. E rëndësishme është që ato të përcillen tek brezat e rinj, çka përbën edhe qëllimin kryesor të Degës së Unionit "Mirdita" në Shkodër.

Fotot në këtë aktivitet u realizuan nga fotografi Artan Marku, të cilin e falënderojmë për gatishmërinë dhe punën e mrekullueshme që realizoi së bashku me bashkëshorten e tij

Festa të tilla urojmë të kemi gjithmonë. Jetë të gjatë Unionit "Mirdita" në Shkodër,

suksese të mëtejshme në ruajtjen dhe lëvrimin e traditave dhe kulturës popullore të krahinës së Mirditës.

Përgatiti zj. Kozeta Bruçi



# MARTIN ÇETINA JETOI ME NDER E FISNIKERI SHËMBULLORE DHE SI I TILLË U PËRCOLLË PËR NË BANESËN E FUNDIT

Kur përmendet emri i Martin Çetina, menjëherë të shkon mendja tek fisnikëria dhe vlerat që përcjell ky burrë i Lekajve të Dukagjinit.

Burri që trashëgoi cilësitë me të mira të malsorit. Njeriu që bëri gjithçka për familjen e rrethin e tij të gjerë, për komunitetin e madh Dukagjinas të dalë nga lufta, me probleme të mëdha ekonomike dhe me varfëri të madhe.

I lindur në një familje të nderuar në 02.07.1937 të fisit sojnik e fisnik të Deliajve të Lekajve të Shalës. I biri i Dedë Ndout dhe i Kadë Lushes së Lush Nikës nga Nicajt e Shalës, Kada, nga dera e fisme e Çun Nikës, burrit që dha jetën përkrah Mehmet Shpendit në Ndërkisa të Planit, së bashku me 79 dëshmorë të tjerë, të cilët ranë në altar të lirisë për tu kujtuar gjithmonë. Grue fisnike e njohur në Dukagjin, e trime si Nora e Kelmendit.

Qysh i vogël te ky burrë i madh spikatën cilësitë më të mira të malsorit, ndera, përkushtimi për miq e të afërm që e lartësuan këtë burrë, duke e radhitur në elitën e burrave të Shalës. Cilësitë e tij të veçanta, përkushtimi ndaj punës dhe shkollimit, dashuria dhe respekti ndaj njerëzve e bënë që të ishte një nder figurat më të dashura dhe të nderuara të zonës së Dukagjinit.


Familja e tij e madhe me vëllezër Markun e Ndocin e motrat fisnike Dranden, Mrinë, Sosen e Linën.

Shkollimi është dashuria e tij e madhe, duke mbaruar filloren në vitin 1951, me rezultate të larta.

Për derën e madhe e fisit të Deliajve shkolla që pjesë e jetës së tyre.

Mësues, mjekë e profesione të ndryshme emrat e Dr Zef Delisë, Pjetër e Gjokë Delisë i bëjnë nder Shalës e gjithë Shqipërisë së Eperme.

Duke qënë i apasionuar pas dijes e shkollimit ai u bë nismëtar që në fisin e tij të shkollohen përveç fëmijëve të



tij edhe nipa dhe mbesa.

Fillimet e tij janë aksionet e mëdha kombëtare në rindërtimin e vendit, në Postribë e në vende të tjera.

Grueja e tij fisnike Lulë Dedja e shtoi këtë derë me tre djem Lazri, Plumbi, Petriti që po rritin nipa e mbesa model në jetën e tyre.

Kujdesi e dashuria për motra e vëllezër që treguesi i madh i dashurisë njerëzore.

Kujdesi tregoi për Sosen, motrën e tij të martuar në Theth, dhe përkujdesja e vazhdueshme për të ardhmen fëmijëve të saj. Nuk mungonte kurrë në gëzimet e tyre edhe pse larg motrat Drande e Linë në Qeresh e ndjenë vazhdimisht dorën e ngrohtë të vëllait.

Si rezultat i punës dhe shkollimit ai u emërua mësues në Abat Shalë në vitet 60' - 61' dhe në Gjuraj Pult. Si mësues i ri dhe me mjaft përkushtim

përcolloi tek nxënësit dijet dhe virtytet më të larta të malsorit, dashurinë për dije dhe punë, historinë e lavdishme të trevës së tij dhe mbarë kombit të vet.

Arsimin e mesëm e bëri në "Normalen e Elbasanit" që për kohën ishte një universitet.

Kjo shkollë quhet Universiteti i parë Shqiptar me mësues e drejtues të kësaj shkolle si Luigj Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani, Simon Shuteriqi, Haki Peci, që janë personalitetet më të shquara të arsimit kombëtar. Tashmë formimi i tij mori të tjera përmasa duke ngritur në një shkallë të lartë kulturën shkencore.

Si i ditur dhe i shkolluar më 12 Dhjetor 1967 emërohet kryetar i Kooperativës Lekaj.

Si njeri i shkolluar dhe familje me vlera dha një kontribut të madh në këto kohë të vështira, ku terreni dhe klima malore e bënë mjaft të vështirë punën dhe jetën e banorëve të këtyre viseve.

Komunikimi dhe dashamirësia janë arma e fortë e burrit të kompletuar dhe mirëshkolluar Martin Çetina. Zoti i kish dhënë këtij burri të madh një cilësi të veçantë armën e artë të komunikimit.

Në vazhdim të karrierës së tij në vitet 70 emërohet Drejtor i Shkollës Abat.

Investimi në fushën e arsimit dhe të mirë edukimit e vlerësimi maksimal për punën e tij bëjnë që në vitin 1972 të emërohet sekretar i Pushtetit Lokal në Dukagjin dhe në vitet 73' - 79' Kryetar i Këshillit të Bashkuar Shosh - To-

planë. Të punosh në detyra të tilla drejtuese me një problematikë të madhe dhe të fitosh zemrën dhe dashurinë e njerëzve vetëm një burrë zotni si Martin Çetina mund ta bënte.

Duke qarë hallet dhe problemet e popullit dhe duke i ndihmuar ata me gjithë kapacitetet e tij e ngritën shumë lart figurën e tij tashmë duke marrë edhe përmasa kombëtare.

Tashmë gjysh i nderuar i shumë nipërve e mbesave të shkolluar që jetojnë e punojnë në katër anët e botës, e pranë Henrit, nipit model në shkollë e jetë e duke treguar historitë e shumta të jetës së tij. Edhe pas daljes në pension në vitin 2002 puna dhe veprimtaria e tij nuk pushoi.

Në vazhdimësi ishte pranë komunitetit dhe njerëzve duke dhënë mendimet dhe eksperiencën e tij të gjithanshme në shërbim të rritjes së nivelit të edukimit dhe kulturës njerëzore.

Duke parë tashmë aftësitë e jashtëzakonshme komunikuese në vitin 2006 zgjidhet kryetar i Shoqatës "Shqiperi - Itali" për Shkodrën.

Tashmë emri i ti merr edhe përmasa nderkombëtare duke marrë pjesë në takime dhe forume e duke ndjekur hap pas hapi hallet dhe problematikat e komunitetit Shqiptar në Itali dhe lidhjet me vendlindjen e tyre.

Jetë me nder dhe me vlerë, ky është përkufizimi për jetën e Martin Çetina.

Njeriu që fali shumë dashuri për njerëzit, burri që bëri gjithçka për njerëzit dhe komunitetin ku jetoi.

Njeriu që i bën nder vendit nga vjen dhe plotëson vazhdimsinë e burrave fisnikë me emrin dhe vlerat e veta.

E lehtë të qoftë lëndina ku do prelesh o Martin Dedë Çetina!

**Lulash Vatnikaj**

## QYTETAR!

Qytetar, mos rri i heshtur, qytetar,  
Nuk është koha për të fjetur, mor qyqar;  
Fare hapur po të tallin, si jesmen,  
Pas kurrizit po ta kallin, derdimen.

"Tre Kamberë" në një derë, ke ti sot,  
Njëri drizë, të tjerët ferrë. Mos o Zot!  
Që të tre të zotohen, ditë e natë,  
Jargaviten, përbetohen në fushatë . . .

Oh sa fort të përqafojnë, të qajnë hallin,  
Po kur lumin e kalojnë, të pjerdhin kalin;  
Dhe ti mbetesh në mes të rrugës, për nishan,  
Të vjen shpirti në majë të hundës, s'ke derman.

Për pesë lek ty të shesin, mor zavall,  
Mjaft që plot ta mbushin thesin, personal;  
Shesin ty dhe Shqipërinë, pa merak,  
Korrupsionin, tradhëtinë, kanë në gjak.

Se të "tre" këta liderë, aferim,  
Janë "Kamberë në një derë", s'ka dyshim;  
Janë kuaj të borgjezisë, s'e luan topi,  
Në karrocë të qeverisë, ndërron konopi . . .

Prandaj "Shqipo", thirri "Qokes", sa s'është vonë,  
Dili zot ti Nanlokes, si gjithmonë;  
Zgjohu, dil nga kjo jermi, bukurosh,  
Kokën lart me krenari, Tarabosh;

Se Vatani është i yti, je pronar,  
Kush ta shet, kape për fyti, si zuzar;  
Jetës tënde dili zot, me guxim,  
Nga të tjerët mos prit kot, miku im . . .

Mos lejo me ty të tallen, të kam xhan,  
Kush të tall, martoja "hallën", je SOVRAN!

poezi **GJON BRUÇI**


# GULJEM RADOJA NJË MADHËSHTI DHE BUKURI E PA VDEKSHME

(Le të qajnë me lot skenat dhe ekranet tona për humbjen e birit të ndritur të artit)

Me kalimin e viteve vërej se jo pak ëndrra me dëftojnë, pavarësisht se kurrë nuk kam dashur tu kushtoj kujdes. Mbrëmë mu përfytyrua e isha në majën e Bigës e Gimajve e dyta më shtatanikja e Alpeve. Pa pritur në faqen nga Gimajt u rrezua një shkëmb i madh që mori para si orteku një rrëgallinë të terë gurësh. Një tymnajë e bardhë u ngrit si re dhe pushtoj gjithë pllajën e Radojës... Malet i dua, i shëtis dhe ëndrrat në male nuk më trishtojnë, pavarësisht se orteku karbonatik dhe osh-tima e tij mbrëmë më nxorën gjumin. Nuk e bëra kuvend me as kënd as nuk i kushtova fare vëmendje, por kur mësova se sot vdiq Guljem Radoja vendosa të bej publike. Kur dhembet e kreshtave shkoqen priten vdekje viganësh. Biga dhe Radoja e parandjeu dhe qau vdekjen birit të saj që i trashëgoi emrin për llagap. Ky artist i madh rrënjën boshtore dhe gjakun ushqyes kapilar e pati nga pllaja lëndore e Radojës. Ora rojtare e mbikëqyri nga Biga e Shalës sythet i çeli në Shkodër, u përkund me ninulla dashurore, u rritë në shtëpinë e artit dhe u be Senior i skenës dhe ekranit. Starti ti tij i duhishëm fillon nga Librazhdi, dhe meandroi në Mallakastër, Fieri, Tiranë por Durrësi e rrëmbeu dhe beri për vete sa nuk dinte ta ndante vetën në ishte shkodoranli apo durrsanor.

Guljem Radoja është një shqyt emblematike denjë në çdo skenë arti.

Burrë i pashëm me trup të hijshëm



sportiv, serioz, trendi me sy shkëlqimtarë si yll që përthyer në det. Ai zotëronte një plastikë aktoriale të veçantë zë të ngrohtë si burim termal dhe oratori gurgulluese.

Gjithsesi më shumë se hijeshia fizike tek Radoja mbizotëroi dituria dhe bukuria artistike e cila nuk është kalimtare si bukuria tokësore.

Aktor i nivele të larta me interpretim dhe ngjyrimi emocional si në rolin e mirë apo të keq. Guljem Radoja kishte profil të lartë intelektual karakter të fortë, fisnik pa vese shumë kërkues ndaj vetes dhe partnerit në rol dhe aspak egocentrik. Person-

azhet e mishëruara nga Radoja bien në sy për origjinalitet, për elegancën, duke frymuar karaktere me ndryshime të ndjeshme nga njeri te tjetri, të përzgjedhur me mençuri dhe intuitë. Radoja është personalitetet që ka lënë gjurmë dramaturgjie si njohës maksimal fjalës skenike por mbi të gjitha, ai është thesar i çmuar për kontributin artistik në kinematografi. 75 vjeçar pa shenja pleqërie veç pak kohë me pare një hije vdekje e erdhi vërdallë si hienë grabitqare. Gjithë familja ju mblodh me dashuri për qark, por jo shteti që kishte borxh dhe detyrim moral. Jeta e Radojës sosi dhe pritej me sot e me nesër, lajmi i vdekjes së tij

trishtoi gjithë botën tonë artistike. Le të qajnë me lot skenat dhe ekranet tona për zhdukjen e birit të ndritur të artit. Guljem Radoja u largua i trishtuar por mbet këtu mes nesh kujtimi i tij në zemrat e miqve dhe dashamirëve të filmit dhe dramës. Radoja u rrëzua si petale trëndafil, por mes nesh to mbetet të pa plakur Petronini (Kush Vdes në Këmbë) Stefan Bardhi (Mësonjëtorja), Gjenerali te (Gjeneral Gramafoni), Major Kelli, (I treti) Prifti te (Kthimi i ushtrisë së vdekur) inxhinier Ylli. (Në pyjet me borë ka jetë) Tenente Gurabadi, (Në fillim të verës) Kryeprokurori (Kolonel Bunker), Pertefi (Vrasje në Gjueti), Arkelogu (Te shembje e idhujve), Serveti (Gëzhoja e vjetër) e të tjera e të tjera.

Pastë dritë në amshim Artisti i madh me gjak dukagjinasi Guljem Radoja. Tashmë çdo kush e di se Guljem Radoja, Pjeter Gjoka, Ndreka Luca, Lec Shllaku, Viktor Bruçeti në botën tjetër dhe Tinka Kurti Fredeik Ndoci e të tjerë në këtë botë përfaqësojnë një armatë artistike. Kush do guxonte të matej me ta?! A nuk është vallë shprehja me lartë e madhësisë së genit dukagjinasi. Ngushëllimet me të përzemërta gjithë familjes Radoja. dhe në mënyrë të veçantë mikut tim të çmuar Redi, nip i të disidenti shquar Beqir Ndou. Zoti ju forcoftë për dhimbjen e rendë të njeriut tuaj më dashur!

Prele Milani

## Respekti - "lubrifikanti" i shoqërisë njerëzore

Koncepti respekt, ka shumë fytyra dhe përfshinë shumë fusha të jetës. Është një „paketë“ e tërë, me shumë elemente. Ndoshta kjo është arsye që, psikologët dhe filozofët, nuk kanë arritur në një mendim të përbashkët, për përkufizimin e konceptit respekt. Megjithatë kjo nuk na pengon aspak për të kuptuar këtë koncept, në marrëdhëniet me të tjerët dhe botën që na rrethon.

Baza e respektit janë dy parimet themelore të ndërtimit dhe funksionimit të shoqërisë njerëzore: Barazia dhe drejtësia.

Pa këto nuk mund të ndërtohet dhe as të funksionojë asnjë shoqëri njerëzore. Për të arritur këto dy parime themelore, duhet që, të gjithë aktorët e jetës shoqërore, të respektojnë njëri-tjetrin. Ndryshe, nuk bëhet. Ndryshe nuk ka kurrë paqe sociale.

Çfarë do të thotë respekt?

Respekt, në radhë të parë dhe mbi të gjitha, do të thotë: Respektim i sferës private dhe pronës së tjetrit. Mënyrat për t'a shprehur respektin ndaj tjetrit janë: Kujdesi, mirësjellja, ndershmëria, mirënjohja, toleranca, humanizmi, bashkëndjenja, solidariteti.

E parë në anën psikologjike, respekt do të thotë, qëndrimi i një subjekti ndaj një objekti.

Ky qëndrim nuk duhet menduar si shkak i kërkesës së tjetri por, për faktin se njeriu vetë nuk mund të ndërtojë marrëdhënie me të tjerët pa një qëndrim të tillë, pa faktorin respekt.

Psikologët, vazhdimisht, debatojnë mbi prejardhjen e respektit: Nëse është i lindur (gjenetik) apo i fituar.

Shumica janë të mendimit se, njeriu, është qenie sociale dhe si e tillë, nga natyra, është

programuar me aftësinë e komunikimit social. Diku, në pjesën frontale të trurit, është fiksuar „busulla“ e orientimit social. Njeriu, që nga momenti që fillon të ngrihet mbi këmbët e veta, e kupton se nuk bën dot pa ndihmën e të tjerëve por, akoma nuk e din si arrihet ajo. Një gjë të tillë i duhet t'a mësojë. Sa më shpejt dhe sa më mirë.

Koncepti respekt, për faktin se nuk ka përkufizim, shfaqet në forma të ndryshme. Nëse dikush thotë se, ka respekt për qenin kafshues, në fakt ai tregon frikë. Pronari, kur flet për respekt nga punëtorët, në fakt mendon bindjen pa kushte të tyre ndaj autoritetit të vet. Të moshuarët, kur flasin për mungesë respekti nga të rinjtë, mendojnë mungesën e mirësjelljes.

Mësueset ankohen për mungesë respekti nga nxënësit e tyre. Nuk duhet menduar kështu. Në të vërtetë mësueset kërkojnë heshtje dhe bindje të plotë nga nxënësit, para autoritetit të tyre. Respekti për mësuesin dhe bindja e plotë para autoritetit të mësuesit janë dy gjëra të ndryshme. Nëse nxënësit thonë, ne nuk e respektojmë mësuesin, nuk është fjala për autoritetin e mësuesit por, për vetë mësuesin, për individin. Sipas mendimit të tyre, mësuesi, personalisht, nuk meriton të respektohet dhe nuk e ndjekin shembullin e tij. Nëse njeriu e respekton dikë, shkon pas tij vullnetarisht, pa kushte.

Psikologët flasin për dy lloje respekti:

1 - Respekti i „tufës“, i individit ndaj të gjithëve dhe i të gjithëve ndaj individit. Ky bëhet pa asnjë kusht. Të gjithë njerëzit men-

dohen të barabartë nga vlerat, pavarësisht nga raca, seksi, prejardhja, moshja, bindjet politike dhe fetare. Dinjiteti i njeriut është i paprekshëm, kushdo qoftë ai. Askush nuk ka të drejtë t'a gjykojë apo paragjykojë tjetrin. Vetëm organet gjyqësore kanë të drejtën të deklarojnë fajtor ose të pafajshëm njeriun e dyshuar. Vetëm ato kanë të drejtën t'ia kushtëzojnë liritë dhe të drejtat individit.

2 - Respekti për të veçantët, për ata që, me përkushtimin, talentin dhe aftësitë e tyre të veçanta, i kanë dhënë shoqërisë gjëra të veçanta.

Vlerësimi i figurave të shquara të kombit, gjithmonë bëhet nga organet kompetente të shtetit, të caktuara me ligj. Të tjerët vetëm duhet t'i respektojnë.

Respekti, ashtu si çdo koncept tjetër në jetën sociale, ka zigzagët e veta. Sa më heterogjene që është shoqëria, aq më shumë forma të ndryshme respekti shfaqen. Në raste të tilla mund të flitet për pluralitet vlerash. Njerëzit e kulturave të ndryshme, për të njëjtat gjëra, kanë prioritete të ndryshme.

Pyetja shtrohet: Si mund të merremi vesh të gjithë, për vlerat e përbashkëta, pa e poshtëruar njëri-tjetrin? Si mund të zbutet konflikti midis gjeneratave?

Pikënisja e respektit ndaj tjetrit, është respekti ndaj vetvetes. Vetëm ai që njeh dhe respekton vlerat e veta, mund të njohë, pranojë dhe respektojë vlerat e tjetrit. Njeriu i „vetëburgosur“ nuk mund të mendohet kurrë se mund të njohë, vlerësojë dhe respektojë jetën dhe vlerat e të tjerëve.

Dikush mund të mendojë se, ne kështu kemi jetuar, kështu kemi ardhur deri këtu, me dhunë dhe pushtë në faqe.

Po, ashtu është por, rendimenti i jetës ka qene shumë i ultë. Varret janë mbushur me të rinj, familje dhe fise janë shuar dhe jeta, e

një mase të madhe individësh dhe familjesh, ka qene ngujim në kulla. Edhe sot, në shek. 21 kemi ngujim në kulla, si në Mesjetë. Jeta është mbijetuar dhe jo jetuar.

Respekti është „lubrifikanti“ i shoqërisë njerëzore, zbutësi i fërkimeve, në çdo kohë, regjim, kulturë dhe religjion. Pa këtë mjet „lubrifikimi“ çdo shoqëri mund të marrë flakë.

Në marrëdhënie me të tjerët, nuk ka vogëlsira. E drejta dhe privatësia e tjetrit, sado të vogla që mund të duken, nuk janë vogëlsira.

Diku, brenda njeriut, është rrënjëzuar ndjenja e poshtërimit. Në kushte paqeje sociale, ajo dremitet. Nëse dikush e injoron apo sulmon tjetrin, ajo zgjohet menjëherë tek viktima dhe, jep alarmin.

Tjetri mund të të fal kohë dhe gjëra të tjera, nga të vetat por, vështirë se ta fal aktin e poshtërimit.

Më ka ndodhur disa herë që, kur kam shkuar diku në radhë, për të kryer veprime, kam pyetur: “Kush është i fundit?” Askush nuk më është përgjigjur. Dhe përse!? Sepse të gjithë duan të futen pa radhë. Secili mundohet t'ia heqë tjetrit edhe atë të drejtë të momentit, për t'u futur sipas radhës, pa menduar se çfarë reaksioni mund të shkaktojë një veprim i tillë tek i dëmtuari. Pra, guxon t'a poshtërojë tjetrin.

Njerëzit nuk grinden, dhunohen dhe vriten me njëri-tjetrin për pasuri dhe mungesë ligjesh por, për faktin se nuk e shikojnë dhe vlerësojnë tjetrin me të njëjtat vlera, si veten e tyre. Në një komb ku mungon “polici i brendshëm” civilizimi nuk arrihet kurrë me policinë e rrugës. Pa “lubrifikantin” e shoqërisë njerëzore, pushka nuk ndalet, civilizimi nuk arrihet kurrë. Është e paimagjinueshme një shoqëri njerëzore pa respekt.

Lekë Imeraj-shkrimtar,  
përkthyes, publicist

# MARTINAJT E TROPOJËS NË NEW YORK E PINJOLLI LUSH PEPA (Luçiano)

## Pak histori për shtëpinë

### e Ndre e Balë Prekës, Curraj

Kur kalon nga Qafa e Kolçit e zbrit për në Nikaj-Mertur, çdo udhëtar i dalin para sysh pamje përrallore në çdo stinë: majat e larta e kreshtat e maleve shumicën e kohës të zbardhura me borë, pyjet e paanë të rritura shumë vitet e fundit, rupat e livadhet e gjelbëruara, prozhet me lajthi e kashnjatet me gështenja e arra, pemëtoret e vreshtat, diku - diku të qëndisura për bukuri nga banoret vendas, e të tjera të përkeqësua e të braktisura nga lëvizjet masive të popullsisë.

Gjatë rrugës, kur pushon në pika dominuese, sheh si në pëllëmbë të dorës Majën e Hekurave, bjeshkët e Currajve të Epërm e Krasniqes, Rrukun e Kakinë, Majën e Kores e Shtyllën e Grisë, Thermen e Shllumin e Aprripës, Lugun e Ndërmajës e Vranën piktoreske, lumenjtë e kristaltë të Merturit e të Nikajve që ushqehen nga burime bore prej lartësive të Alpeve, por edhe nga dhjetëra përrenj me rrjedhje të thekshme e të bollshme uji në vjeshtë e pranverë; burimet hidrike e të tjera pasuri të mëdha akoma janë të pashfrytëzuara sa e si duhet.

Në një pushim lehtësues e zbavitës sipër Shëngjergjit, në Kodrën e Spahisë, ballas bie në sy fshati i bukur i Currajve e në qendër të tij Fusha e Kishës, një topnim i trashëguar nga thellësia e shekujve. Sot me shumicë, por edhe më herët shquheshin kullat e gurta dy e tre katesh dikur të mbuluar me rrasa guri, arat e livadhet e sistemuara, kopshtet e brezarret me mure guri, vreshtat e pemëtoret e mirëmbajtura me aq merak e kujdes nga currajt punëtor e civilizues, të shquar si sedërli e novator, për këmbëngulje e aspirata drejt vlerave përparimtare.

Para viteve '60 ngriheshin afër njëra tjetrës edhe dy kulla binjake të arrira në vlera estetike e funksionale: njiheshin kollaj nga më i vogli e më plaku, nga vendasit e bajrakët e malësisë si kullat e Prek Qunit e Mark Qunit, të ndara nga një oxhak e të shquara për mikpritje e bujari, me burra të zot e të përmendur. Sot në atë kodër shohim vetëm themelet e asnjë frymë robi; të tjera banesa të shumta, edhe më të bukura e bashkohore, pasardhësit e atyre trojeve kanë ngritur jo vetëm në shumë qytete të Shqipërisë, por edhe në Evropë e Amerikë.

Djemtë e Ndre Prek Qunit (Pepa, Deda e Lulashi) e kushëriri i tyre Pjeter Bala, nga fillimi i viteve '60, ngritën një shtëpi kullë jo larg së parës, në një vend të sheshtë e piktoresk, më e mira në të gjithë krahinën, më funksionale e me mundësi jetese më të mira.

E ndërtuar me ranë lumi, me mur guri të latuar, me qoshe të gdhendura e qëndisura nga mjeshtrit më në zë të Nikaj-Merturit e Dukagjinit, të udhëhequr nga Lulashi, i shquar për punë të fortë e mjeshtri të hollë; me dyer e dritare plot dritë, ndriçuar nga rrezet e diellit jetëdhënë pothuajse gjithë ditën, me korridore të gjëra e shkallë të drunjta, dysheme e

tavane me pishë të kuqe marrë në Kakijë e afër Majës së Hekurave, me çati alpine, me trarë e ngrehinë gështenje mbi 100 vjeçare, pa harruar të shënojmë ballkonin e gjerë, ujin e rrjedhshëm e tualetet; dhome pritja me orendi të bukura, bujare për njerëz të thjeshtë e burra të shquar të malësisë e deri për udhëheqësit më të lartë të pushtetit vendor e qendror.

Kjo shtëpi karakteristike u ndërtua me parametra bashkohor, me art e dashuri, frymëzuar nga ato që kishin dëgjuar e parë si njerëz të shëtitor e të ditur, pa harruar këshillat e porositë e vyera të oficerëve të asaj shtëpie: Marashit, Nikolës, Gjonit e Lazrit. Si kazermë dukej ajo shtëpi në atë Fushë Kishe prej asaj pune titanike. Shumëkush mendonte se zori më i madh ishte kryer, por jo; më e madhja sa kishte filluar në atë rrafshinë tokë rënde, në ato shpatina e rrëpira toke të mbushura me gur e shkëmbinj të gjallë, ferra e shkoza. Punuan si luanë ditë e natë, hapën toka të reja, bënë sistemime, zgjeruan e bashkuan sipërfaqe, mbollën pemëtore e vreshta, eksperimentuan e provuan varietete të reja; shtuan dukshëm bagëtinë e kosheret e bletëve.

Unë kam lidhje shoqërore e miqësie e me dhjetëra herë kam bërë vizita familjare e pune në ato troje e në atë fshat që ngjan me një oazë parajsë. Mund të shkruaj një roman, por po veçoj sa më poshtë:

1) Sot, ndonëse janë larguar të gjithë, aty banon e kujdeset për gjithçka një familje tjetër e një lagjeje tjetër (Pashk Lekaj), çka tregon shumë për harmoninë e urat e komunikimit.

2) Befasohet njeriu me murembajtëset "Ilire" të fund arave e brezareve me gur mesatar mbi 1 metër kub e më të mëdhenj.

3) Lëvizja e shtratit e sistemimi i një përroi të rrëmbyeshëm me përmasa të konsiderueshme e me ujë shumë në stuhi që përpinte tokat e zhvendosja disa metra larg, duket si e pabesueshme.

4) Mirëmbajtja e pyllit, e pemëtoret e vreshtave, apo mjediseve rrethuese, ruhet edhe sot në këto vite të vështira tranzicioni. Prodhimet bio nuk kanë të krahasuar.

5) Pa përmendur ndodhi të tjera ju kujtoj lexuesve se në atë Pemëtore me zë u organizua një miting i madh në Qershor 1983, në të cilin mori pjesë numri dy i Partisë e Shtetit, Ramiz Alia, i cili bëri një vizitë edhe në këtë familje.

6) Afër Rrasës së Currajve, në një pozicion turistik të veçantë, aty ku lumi përbiron me vështirësi mes Mulajve e Currajve, hapën toka e ndërtuan një shtëpi tjetër të re.

7) Janë tregues të pashembullt frymëzimi këto që thashë e të tjera të pathëna. Shquhet kjo vllazni e gjithë fshati për punë e vullnet të hekurt, por edhe si arsimdashës.

Në librin tim Krenari për Vendlindjen (Triptik për Nikaj-Merturin) në vitin 2006 nga kjo familje e madhe kam evidentuar 15 universitarë. Sot kjo shifër është dy e tre-fishuar.

8) Të shkruash me objektivitet e realizëm e të mos përmendësh gratë e asaj familje do të ishte një mangësi e madhe. Pa hezitim mund t'i quash heroina krah atyre burrave në zë. Rushe Baftia që krye zonjë, si një nënë e dytë e model për Zojë Rexhen, Dilë Fragen e Zojë Zefen e më të rejat Lezina Prendin e Lule Ndonen, pa harruar edhe zonja e zonjusha të tjera e djem të rinj me ambicie pozitive, me kërkesa e ëndrra të guximshme për jetën.

U rrit kjo familje e madhe pa u ndarë deri në 4-5 breza, me shumë kurorë e shumë fise brenda.

Pa bekimin e këtyre zemërbardhave e duarartave, fort më herët do të shpërbehej ajo kullë me emër.

Disa vite pas ngritjes së kooperativës bujqësore, kur jetesa u vështirësua, Deda iku në qytetin e "Bajram Currit" e Lulashi në shtëpinë e re tek Urëvaja; në ato troje të reja me mikpritje të spikatur.

Pepa e Pjeter Bala familjarisht, ndonëse të larguar në breza, jetuan së bashku edhe shumë vite, deri kur ndërtuan aty afër një kullë tjetër model.

I shpërndau jeta e zhvillimet e vrullshme shoqërore, mbijetuan me arritje e jetesë fort më të mirë, mbështetur në punën e ndershme e sfidat e egra të konkurrencës. Vetëm në New York janë mbi 50 pjesëtarë të kësaj familje, përfshirë nipër e mbesa. Janë integruar e përshtatur në atë qytet metropol, secili e ka gjetur vetveten e mbijeton me dinjitet e sakrifica, rinia shkollohet e më të rriturit punojnë e nderohen pa paragjykim nga komuniteti vendas e i ardhur. Marrin dije bashkëkohore, por nuk harrojnë gjuhën shqipe (apo e mësojnë më të vegjlit), nuk harrojnë as historinë e kulturën e kombit shqiptar me të cilën me të drejtë krenohen. Bëjnë vizita te njeri-tjetri e mbledhen shpesh për raste gëzimi a hidhërimi, fatmirësisht këto të fundit më të radha. Shtëpia e Lush Pepë Martinajt i mbledh më së shumti ku shmallen, gëzojnë e festojnë në harmoni familjare, duke kujtuar e rikujtuar me mall vendlindjen e paharruar, Tropojën e gjithë Shqipërinë.



Pepë Ndre Martinajt

## Pepë Ndre i Nikajve, përballë sfidave të jetës

Pikë lidhëse e indicie për këto shkrime është nxënësi im Lush Pepe Martinajt, por të flasësh për të, për Martinajt, pse jo edhe për Currajt e të mos shkruash për Pepë Ndreun është e pamundur.

Ndre Preka, që i përmendur si burrë i traditës për bujari e trimëri, për qëndresë e dinjitet përballë çdo sunduesi vendas apo të huaj.

Pepa ka qenë i njohur në të gjithë Veriun e Shqipërisë e ka ndikuar dukshëm në formimin e personalitetit të Lushit, i cili trashëgoi prej tij shumë cilësi fizike e

vlera morale. Malësia ka pasur e ka burra në zë e Pepe Ndreu i Nikajve qysh se i riu radhit krah tyre.

Me trupin e gjatë si qetinë pishe e kapuçin e bardhë, qysh në rini ra në sy nga i madh e i vogël. Edhe në Tiranë për afër 15 vite e deri sa u nda nga kjo jetë, e mbajti atë trup të drejtë, këmishën e bardhë e kapuçin si bora kur shkëlqen nga rrezet e diellit në qiellin pa re, aq sa edhe dashamirët e tij habitëshin e bëheshin disi xheloz. Në raste gëzimi e hidhërimi, në kuvende e tubime, në oda burrash e salla mbledhjesh, ishte e pamundur pa u shprehë ai; pritej fjala e mendimi i tij. Orator i lindur e artist prej natyre, me gjestikulacione të gjetura e të përmbajtura, me një zë karakteristik, kumbues e metalik, herë pajtues, i shtruar e i qetë si lumë fushor, herë të ngritur e imponues, me pauza e digresione spontane, me fjalë të gjetura e ngarkesë emocionale, por edhe rrëmbyeshëm e kërcënues si lumë malor. Ka pasur e ka të tillë sa thamë më lart, por janë të radhë ata me një mendje të hollë e logjikë si ai; argumentues i zoti, njohës i traditave, kodeve e mendësive të kohës, psikolog i pa shkollë.

Edhe pse i pa arsimuar, që diplomat popullor i shkallës së lartë, parashikues i situatave e aleancave në mjedisin rrethues, pse jo edhe racional e pragmatist (kush më shumë e kush më pak, cili në jete nuk që pragmatist).

Atdhetar, energjik e i palodhur, trim e mikpritës, respektues për çdo shtresë, punëtor i jashtëzakonshëm, arsimdashës i zjarrtë (6 nga 8 fëmijët e tij kanë mbaruar shkollën e lartë).

Gëzonte respekt e kishte shumë autoritet, por kishte edhe kundërshtarë siç ndodhë kudo. Duronte e dëgjonte me vëmendje, por, kur teprohej, e "zhveshte shpatën" e ishte sfidues e i papërmbajtur përballë rreziqesh me pasoja të rënda; triumfonte kundër shpifësve e arrogantëve.

Në raste gëzimi e hidhërimi, i printe gjithmonë karvanit si bajrak, e hijeshonte kuvendin ndaj kërkohej e respektohej.

Nga miq e "armi" shumë është folur e flitet për këtë njeri me vlera të pamohueshme. Jeta e tij e hapur, por edhe me mistere e enigma të pathëna. Në vitet '50 e '60, flitej se ka qenë anëtar i Partisë Social Demokrate ilegale të kryesuar nga Pjetër Arbnori, se ka mbajtur me bukë e strehuar kaçakë e diversantë, se ka sabotuar në fshehtësi ngritjen e kooperativës bujqësore, se kishte krushqi me familje me përbërje të keqe politike, se njihej e vlerësohej nga qeveritarë të lartë, se shumë direktiva e vendime Partie para se të shtroheshin në popull, konsultoheshin me Pepën, se ka bërë pajtime të fshehta në familje e mes familjesh, mes kuadrosh e grupe kundërshtarë, mes fshattrash e fisesh. Me drejtësinë e mençurinë e spikatur ishte sugjestionues e imponues; për shumë vite kryetar i këshillit popullor të fshatit, anëtar e zëvendëskryetar i komitetit ekzekutiv të lokalitetit e më vonë të këshillit të bashkuar të koopera-

tivës bujqësore Shëngjergj apo në forume të tjera.

U përpoqën ta frenonin e ta nënshtrojnë, por nuk ia dolën dot. Dështakët e kundërshtarët ( madje edhe kuadro partie e pushtetarë) e sulmonin për probleme politike e njolla në biografi me akuza të rënda që kushtonin shumë, të qëna e të paqena, por qëndroi si lisi në furtunë e çdo herë doli fitimtar.

Për 15 vite në Tiranë bëri një jete aktive në shërbim të familjes e komunitetit.

I palodhur e këmbëngulës, me shokë e miq, me zyrtarë e pushtetarë, i ndiqte ditë për ditë punët e problemet e shumë prej tyre u zgjidhën: për legalizimet, për dritat elektrike, për rrugë e kanalizime, për ujëra të zeza e të bardha, pa harruar përkushtimin maksimal për të bërë model shtëpinë e bahçen përreth. Ai nuk e kishte lexuar poetin e famshëm Geten gjerman, por kush më mirë se ai e zbatoi mesazhin e tij për një jetë aktive e të dobishme në të gjitha periudhat e jetës së njeriut.

I tillë qëndroi deri në janar të vitit 2011, kur një arrest kardiak ia pushoi zemrën. Rrallë kam parë aq shumë njerëz në një përcjellje mortore.

### Lush Pep Martinaj i peripevice e suksesit



Lush Pep Martinaj

Lush Pepa, ndër 8 fëmijët e Pepë Ndreut, qe më i vogli; siç dihet, 6 prej tyre me shkollë të lartë. Kur lindi u gëzua i madh e i vogël, jo se nuk kishte mashkuj kjo shtëpi, por do t'i shtohet më vonë edhe një burrë këtij trualli.

Si fëmijë i pleqërisë u desh e u respektua si të ishte i madh; rritej e hidhte shtat çdo ditë e në trup e në mendje i ngjante shumë të atit.

Shkollimin e parë i kryen në Curraj, ndërsa arsimin 9-vjeçar e të Mesëm të Përgjithshëm në qendër të krahinës së Nikaj- Merturit.

Më vonë ndjek studimet universitare për mjekësi të përgjithshme e i përfundon në vitin 1994.

Për arsye të lidhjeve familjare e detyrës sime si mësues e drejtor për shumë vite ruaj shumë kujtime për intelektin e natyrën trazovaçe qysh se i vogël. Shkolla ku mori maturën qe e Mesme e Bashkuar, bujqësore plus gjimnaz plus 9- vjeçare. Lushi qe në maturën e parë të Gjimnazit, degë e hapur në vitin 1985, disa vite më vonë se Bujqësorja (1976).

Qysh në ditët e para ra në sy në rrethin shoqëror e ndër mësues, ndonëse nuk ishte krejt i panjohur. Ndër më të mirët nxënës, me një intelekt të lindur, me një zhdërvjelltësi e sedër pozitive, hiperaktiv e pasionant.

Me ditë të tëra qëndronte ndër më të mirët me rezultate maksimale, por kishte edhe "punë të tjera", ndaj shpesh edhe luhatej e përsëri dilte në krye. E rrëmbente sporti, veçanërisht futbollit, gjimnastika e atletika.

Në atë natyrë fantastike e plot diversitet e larushi rrëmbehej nga udhëtimet, ngjitjet alpine, nga flora e fauna, nga bora e madhe e ortigjet e shumta. Arena ku shpërthenin energjitë e tij ishin Fushat

e Kole Balës, kodra e Korrenit, pyjet e shkëmbinjë e Rrukut, mjediset e Shkollës së Mesme e sa e sa vende të tjera të paharruara. Lumin e Merturit e kishte jo larg shtëpie, ku mësoi not qysh në klasat e fillores. Shumë kohë kaloi brigjeve të atij Lumi me ujë kristal e reflekse mara-ramendëse.

Nga Rrasa e Currajve e Shkëmbi i Mulajve, mes atyre pamjeve mahnitëse, të bukura e madhështore, ku përbirohej me vështirësi ai lumë e deri sa derdhet në Dri, Lushi edhe sot përshkruan me nostalgji çdo pus, çdo rrasë guri e shkëmbhedhje, shelgjet e myshqet, shtjellat, pragjet e ujëvarat, rrjedhat e qeta e të rrëmbyeshme, cekëtinat e pusët e thellë sterrë të zi, ku veçon Pusterrin e Urevajës që "nuk i gjendet fundi", me mistere e legjenda të frikshme. Përmend llojet e peshqve e ngjalave, ku veçon troftën e famshme pikaloshe të kuqe, tregon për shpella e strofulla ku rrinin egërsirat e malit... Kënaqej e harlisej, po prap mendjen e kishte te mësimet; edhe pse i lodhur librat nuk i lëshonte nga dora deri pas mesit të natës. Me aq studim që bënte, rendimenti ishte maksimal, se edhe koha nuk i mjaftonte.

E shohim ne rolin e liderit, të gjykatësit e avokatit, të komentatorit, arbitrit e trajnerit, të lojtarit e kapitenit, të partizanit e ballistit, të heroit e të burgosurit, të ndër-mjetësit e pajtuesit. Rritej e përvijonte personalitetin e tij, sidomos në dy vitet e fundit.

Aktivizohej në konkurse e olimpiada, në tryeza shkencore, në veprimtari artistike e sportive, por interesat më shume i shfaqte në lëndët matematikë- biologji e edukim fizik. Në një Olimpiadë Matematike në nivel Kombëtar zuri vend të dytë ( edhe e motra Gjystina, në vitin 1984 ishte pjesëmarrëse e grupit të Recituesve të Shkollës së Mesme Lekbibaj që përfaqësoi Tropojën në një Konkurs Kombëtar në Gjirokastër).

Dashuria e përkushtimi, kërkesa e llogarisë, shembulli pozitiv, frymëzuesit e engjëjt mbrojtës nuk i mungonin as në familje, por e nxisnin për më shumë punë e përparim; i ati disi më i rreptë e kërkues, vëllezërit e motrat më të ngrohtë: Ndreu, Agetina, Prella, Natasha, Gjystina ( respektivisht mjeku, inxhinierja, juristi, mësuesja, ekonomistja).

Mbaron Maturën me rezultate shumë të mira e fiton të drejtën për Studime Universitare në Mjekësi te Përgjithshme, degë fort e kërkuar në çdo kohë. Në ato vite filluan edhe ndryshimet e mëdha Demokratike.

Pa mëdyshje rreshtohet krahi Rinisë Studentore me moton " Liri Demokraci", " Ta bëjmë Shqipërinë si gjithë Evropën". Kontributet e tij janë të dukshme e të vlerësuar, por nuk pajtohet me teprimet e spekulimet që bëheshin në dem të demokracisë, sidomos me dhunën e vandalizmat.

I vëllai, i nderuari doktor Ndreu, ish student i shkëlqyer i Berishës, me respekt të ndërsjella, preferoi të vazhdonte punën e mjekut të përkushtuar në Spitalin e Tropojës. Këshillat e tij të urta për Lushin ishin udhërrëfytes në ato kohë të trazuar, veçanërisht ajo për përfundimin e shkollimit.

Disi edhe i zhgënjyer, pas përfundimit

të studimeve Universitare ëndrra e synimi i tij ishte Amerika, për atë vend të bekuar të demokracisë e qytetërimit, ku vlerësohen e respektohen vlerat e njeriut e puna. Në pranverën e vitit 1996 me plot fantazi e ëndrra të guximshme prek tokën e shenjtë të atij vendi. Dilema e tij: t'i përkush-tohej mjekësisë apo të provonte aftësitë e vullnetin në atë Perandori vlerash e përpjekjesh, lider botëror, në themel të cilit janë demokracia e konkurrenca e vlerave.

Jo pa dhembje e ndrojtje zgjedh të dytën: temperamentit i tij nuk e lejonte të zgjaste me vite me shkollë e provime pa prekur suksesin. Pa shumë përvoje rris-kon, provon e "eksperimenton". Shpesh edhe dështon, por prek edhe suksese që i ngjallin optimizëm. Si i thonë fati ndihmon të vullnetshmit, suksesi sjell suksesin. Punon në një kompani ndërtimi sipas tij me një biznes modest. Këto ditë të ndërrimit të viteve 2020-2021 disa telefonata e biseda shumë interesante, plotësim i atij boshllëku e përmallimi shkaktuar nga largimi i tij prej 25 vitesh.

...Kur u shpreha ngushëllimet familjes Martinaj për vdekjen e Zojë Rexhes, fëmijët nga Amerika akoma nuk kishin ardhur. Unë në pamundësi për të marrë pjesë në ditën e varrimit, sipas traditës shkova për një kafe në ditën e tretë me shpresë për t'i ngushëlluar e shëndosur kryet, ndërkohë ata ishin larguar për shkak të problematikave serioze të transportit shkaktuar nga gjendja e rënduar e Pandemisë Covid-19.

Pak ditë me vonë mora në telefon Lushin, ish nxënësin tim për disa vite. Disa biseda të shpeshta, edhe me orë, jo vetëm hapën një kapitull të ri, shfaqën e shpluhurosën kujtimet e së kaluarës, por krijuan edhe një realitet të ri njohjeje; pyetmë hollësisht e treguam për jetën e njeri-tjetrit, për arritjet e dështimet.

Nga njohjet e hershme e takimet e mëvonshme, nga komunikimet e bisedat e ditëve të fundit, me sa kuptova e konkludova, u shfaq një pamje e perceptim i ri, besoj se objektiv e pa deformuar, i pasuruar e plotësuar me të dhëna e fakte origjinale.

Po veçoj sa më poshtë:

1- Një familje të mrekullueshme e konsoliduar, gruaja mjeke e respektuar me origjinë nga një dere e njohur e Nikaj- Merturit; dy vajzat e djali në hullinë e shkollimit bashkëkohore ( vajza e madhe vazhdon për inxhinieri në një ndër shkollat elitë ).

Menaxhon një biznes modest privat me arritje të kënaqshme ( unë them më shumë se modest).

2- Është me pikëpamje republikane në krahi të ish-presidentit Trump. Me datë 6 janar 2021 ka udhëtuar mbi 4 orë për në Uashington në përkrahje të tij, për të cilin përmend kontributet për një Amerikë më të fortë e të pasur, por edhe disa rezerva në metodën e drejtimit.

3- Duke dënuar dhunën e veprimet agresive, është kundër politikave demokrate për stimulimin e një shtrese emigrantësh a banorë vendas mbështetur në një lloj parazitizmi nëpërmes asistencave sociale.

4 -Lushi (tashmë 51-vjeç) ruan lidhjet me rrethin familjar e shoqëror, jo vetën nga mërgata, por edhe nga Shqipëria, lidhje me mendje e zemër që transmetohen e kultivohen edhe tek brezi i ri. Jo

vetëm telefonatat e marrja pjesë në raste gëzimesh e hidhërimesh, por edhe ndihma materiale e monetare tek disa të afërm për nevoja ekonomike, për përballim kujdesi e sëmundjesh, për vizita mjekësore e barna, për rregullim vizash e pasaportash a ndonjë sponsorizim, me merakun për të bërë më shumë.

5-Më shumë për të respektuar dëshirën e babait në Curraj, zgjeron e bën meremtime në shtëpinë ekzistuese, blen tokë e pemëtore duke respektuar me fanatizëm normat e kodet e vendit bazuar edhe në ligjet e kohës.

Në Tiranë ndihmon për blerjen e një shtëpie dy katesh, por edhe në rregullimin e mjedisëve rrethuese përfshirë ngritjen e lulishtes, vreshtit e një pemëtore të vogël.

6- Respekti i tij për ish mësuesit e pedagogët e nderuar.

Edhe për mua shprehë mirënjohje, konsiderata e vlerësime maksimale, aq sa e ndjej veten disi keq, se më duken të tepruara, ndërsa atij i mbetet merak se ka thënë pak.

" Përveç familjes sime, dy idhuj kam në jetën time: Ju dhe pedagogun e shkollës së lartë Gjergj Minga"-shprehet me emocion.

Rri e mendoj, gjykoj e arsyetoj për vitet e gjata në arsim, për moshën time të adolehencës e rinisë, të cilat më ngjajnë me këta moshatare të atyre viteve, ku shoh një pjesë të rëndësishme të jetës sime.

Lushi e një kategori e konsiderueshme moshatarësh, me temperament në mes të kolerikut e sanguinit, duheshin mbajtur afër, këta tipa kishin shumë energji e ëndrra të guximshme, ato duheshin menaxhuar e trajtuar me kujdes profesional e kthyer në realitet . Këtu duket zotësia e mësuesit e drejtuesit. Ndjej kënaqësi e krenari ( jo mendjemadhësi) për aq sa kam bërë, pse jo edhe më shumë. E ndjej veten edhe më mirë po qe se puna ime dhe e kolegëve kanë ndikuar pozitivisht në të ardhmen e Lushit e dhjetëra brezave që kemi mësuar e edukuar.

Në këtë kohë Pandemie të frikshme të fillim vitit 2021,( nga Saint Genis -Pouilly, në pjesën franceze afër Gjeneve), falë mundësive që ka krijuar TIK ( teknologjia e informacionit e komunikimit), kam qenë në kontakt me biseda të ngrohta e miqësore me shumë ish nxënës që jetojnë në Evropë e Amerikë : Jetnor e Visar Vukaj, Lush Martinaj, Bardhyl Ukcama, Skender Perpepaj, Ndreke Gjonpalaj, Ndokë e Filip Vukaj, vëllezërit Palnikaj ( djemtë e Nikollë M. Sadrisë ) e Pjetër nikaj ( djemtë e Nikë Murrecit), Deton Deda, Dritan e Agim Imeraj, Dedë Kroni, Leonard Martinini, Nikë Hasaj, vëllezërit Susaj( djemtë e Gjon Ukë Gjonit) e Bushati ( djemtë e Pjetër e Prekë Palit), Sander Lekaj etj.

Dhëntë Zotit, këta ish nxënës e sa e sa të tjerë, brenda e jashtë vendit, të ruajnë e forcojnë shqiptarizëm, të kenë shëndet e sa më shumë suksese për vete e për familjet e tyre.

**Saint Genis Pouilly, Francë,  
12 prill 2021**

**Frok Vukaj,  
Kryetar i Shoqatës**

"Akademia e Shkencave të Edukimit",  
Tiranë

# Homazh për Gjelosh Ukcamen, në 1-vjetorin e vdekjes

## Dhimbje e paharruar...

*Për Gjeloshin e Prel' Qerimit  
Na qajnë zemrat prej pikëllimit  
Për këtë burrë e atdhetar  
Lotët n' faqe s' na janë tharë  
Në New York n' at Metropol  
Ky fisnik e ka një vorr*

Janë këto vargjet më të fundit në 1-vjetorin e vdekjes së Gjelosh Ukcamaj.

Siç thuhet me realizëm e me ndjenjë "lotët në faqe s' na janë tharë" kuptojmë se dhimbja vazhdon të jetë e madhe në rrethin familjar, në farefis e shoqëri. Humbja e tij e parakohshme në maj të vitit 2020 pikëlloi shumë zemra në vendlindjen e tij në Mertur, por edhe në Tropojë, Dukagjin, në shumë qytete të Shqipërisë e në Diasporë, për të cilin, po të ishte në vendlindje, do të bëhej një gjëmë e padëgjuar në 9 bajrakë, si dikur për xhaxhain e tij të famshmin Kolë Qerimin.

Ai ishte shumë punëtor, familjar i përkushtuar, i dashur me gjithkënd dhe gjithnjë i buzëqeshur. Largimi i tij qe një tronditje e madhe ; iku nga kjo botë dhe do të kujtohet me dashuri nga familja, farefisi, miqtë dhe gjithkush tjetër që e njohu.

Ish Komandanti i Gardës së Republikës së Shqipërisë, Gjeneral Halit Gjeçaj, me të cilin Gjeloshi punoi disa vite, do të shkruante :

"Të njoha vonë i dashuri shok, mik e vëlla Gelosh Ukcama. Por në vitet që kaluam bashkë të njoha shpirtin e zemrën tënde të pastër, madhështinë tënde si shok me vlera, dinjitetin e hijeshinë tënde. Pushofsh në Parajsë. Unë do të kujtoj gjithmonë me atë buzëqeshjen tënde të bukur e të ëmbël".

Miku i tij më i afërt i viteve të rinisë Av. Prel Martini, ish Kryetar i Gjykatës së Apelit të Shqipërisë, do të thurte vargjet:

*O shok i ngushtë, o vëllai im,  
Trupi prehet në kontinentin, që s'linde,  
Kujtimi yt në mua mbet përjetë  
Kur shpirti fluturoi mes engjëjve të qiellit*

Kushëriri i tij, Mjeshtri i Madh Ndue Ukcama shkruan:

"Të gjithë ndjejmë një trishtim të madh në shpirt për Gjelosh Prelën, këtë burrë ndër me fisnikët dhe të jashtëzakonshëm që ka nxjerrë fisi i Ukcamajve. Unë, që kalova një pjesë të jetës afër Tij, nuk gjej fjalë sot për të shprehur dhimbjen e madhe. Dritë i pastë shpirti e kurrë mos u harroftë emri e personaliteti i tij. Le të qëndrojmë, se në traditën tonë, burrat si ai nderohen e nuk vajtohen".

Mjeku i njohur Prend Gjoka, me origjinë prej të njëjtit fshat shprehet : " Ishte një ndër miqtë më besnikë që kam pasur, shumë fisnik dhe burrë i vërtetë, me cilësi brilante e trashëgues i vlerave të derës së njohur prej nga vinte. Lajmi ishte tronditës dhe i pabesueshëm ; e ndjejmë shumë

mungesën e tij. Do të kalojnë shumë vite e shumë e shumë dekada e ai do të kujtohet me respekt të madh".

Poeti i njohur Fran Ukcama, për humbjen e kushëririt dhe mikut të tij të ngushtë, e shpreh dhimbjen e pazakontë në një elegji emocionuese e tronditëse.

Lush Pepa, edhe pse disa vite më i vogël, ka kaluar shumë orë e ditë në vite, në shoqërinë e Gjeloshit, për të cilin veçon shumë cilësi e vlera. Edhe unë e kam ndërjerë thellë këtë humbje, por tronditem, kur me lot në sy, pothuajse pas një viti thotë " Profesor, shkruaj diçka, e meriton.



Burra të tillë lindin radhë: i edukuar, i ditur, i pashëm, familjar i përkushtuar, i traditës e bashkëkohor, atdhetar, komunikues... Vdekja e tij më goditi aq shumë sa mendova se nuk ka rëndësi ma se kë merr ky virus"...

I vëllai Lush Prela, do të shprehej shkurtimisht pranë arkivolit : "Lamtumirë vëlla. Nderove veten, babë e mixhë, familjen tande e trollin ku linde. Shko i lirë e mirupafshim n' at botë"!

Nga të pranishmit vinë shumë përgjigje domethënëse "Ka nderue gjithë Tropojën, asht kanë nderë e vlerë kudo ka punue, në Shqipni e Amerikë"...

Do të donin t'i bënin nderimin e respektin e merituar me qindra e ndoshta me mijëra, por, ndonëse në ato ditë të rënda të Pandemisë Covid-19, komuniteti shqiptaro-amerikan e të tjerë i bënë një përcjellje dinjitare si për një burrë shteti, se figura e

tij ka rrezatuar shumë vlera e dobi.

Në formimin e personalitetit të tij kanë ndikuar shumë edhe traditat pozitive të Malësisë së Gjakovës, familja e tij e shquar për atdhetarizëm, për qëndresë e dinjitet ndaj çdo pushtuesi a sundimtari satrap, për mikpritje, për ruajtjen e lirisë, jo vetëm të trojeve, por edhe të fisit e krahinës.

Gjyshi Qërim Ndou, babai e xhaxhai, Prële e Kole Qërimi, mes legjendës e realitetit ngjanin me Vilhelm Telin e Robin Hudin ; kaçakë disa vite, luftuan hapur padrejtësitë, pa u dorëzuar përballë for-

Lëvizjen Demokratike të viteve 90 ; Bardhyli ishte në frontin e parë.

## Momentet kryesore të jetës

Gjelosh Prela u lind ne fshatin Btoshë të Nikaj - Merturit në korrik të vitit 1954. Studimet e para i nisi në Nikaj-Mertur, të cilin edhe unë e kam pas nxënës në dy vitet e fundit të 8-vjecares.

Në vitin 1968 vazhdon studimet në Gjimnazin e qytetit të Bajram Currit, të cilat i mbaroi shkëlqyeshëm, duke u vlerësuar si një nga gjimnazistet më të mirë.

Në vitin 1972 filloi studimet e larta në Shkollën e Ministrisë së Brendshme. Aty ai shkëlqeu me rezultate të larta në fushën akademike dhe atë të përgatitjes ushtarake; qe një ndër studentët më të talentuar të asaj Akademie në dekada.

Për këtë arsye, sapo mbaroi studimet e larta, u caktua oficer pranë Gardës së Republikës dhe gjatë viteve u promovua në funksione të ndryshme të rëndësishme për kohën, që nga Drejtoria e Ruajtjes së Personaliteteve më të larta shtetërore e deri tek ajo e kuadrit.

Në fundin e viteve 80-të, për shkak të temperamentit dhe papajtueshmërisë me padrejtësitë dhe burokracinë e kohës, Gjeloshin e largojnë nga Garda e Republikës (ku ishte kryetar dege) dhe dërgohet si drejtues i një poste kufitare në Kukës, në zonën e Shishtavecit, ku shërbeu disa vite. Ky ishte një paralajmërim serioz jo vetëm për karrierën e tij si ushtarak, por edhe për mundësinë e një ndëshkimi shumë serioz nga regjimi i kohës; ndëshkim që u rezervohet ushtarakëve, që nuk gëzonin besimin e sistemit.

U rikthye në Tirane, kur diktatura po binte.

Me 10 Dhjetor të vitit 1990, në një takim në zyrën e Komandantit të Gardës, Dane Binaj, do të kundërshtonte thirrjet e disa oficerëve për ndërhyrjen e Gardës së Republikës për të shtypur protestën studentore.

Ky qëndrim i prerë, ishte një mbështetje e madhe ndaj lëvizjes studentore dhe zhvillimeve demokratike në Shqipëri.

Kur një grup oficerësh ekstremistë të Gardës kërkonin të ndërhynin me tanke në Qytetin e Studentëve, do të ishte pikërisht Gjelosh Ukcama, i cili ashpërsisht do të kundërshtonte çdo përzjerje të Gardës së Republikës apo ndërmarrje e veprime të jashtëligjshme. Ai argumentoi:

Së pari, Qyteti i Studentëve nuk është në juridiksionin e Gardës.

Së dyti, atje janë djemtë, vajzat, nipat e mbesat, vëllezërit dhe kushërinjtë tanë, nuk ka armiq atje. Nëse do të tentohet, unë së bashku edhe me oficerë të tjerë do ta pamundësojmë këtë veprim.

U akuzua se përkrahte nipin e tij (B.Ukcamaj), i cili, sipas tyre, ishte në mesin e drejtuesëve, njëri nga armiqtë e rrezikshëm të sistemit.

Më vonë Bardhyl Ukcama,



# Rinia e parë

Rinia e parë fillon pak a shumë në moshën 15-16 vjeçare e shkon deri në moshën 18-19 vjeçare. Është koha kur i riu ose e reja mund të kenë hyrë në punë e, në një farë shkalle, kanë filluar jetën e pamvarur. Ose ndjekin shkollën e mesme. Rinia e parë është moshë ku hidhen themelet e personalitetit njerzor, është pragu i jetës së pavarur e të vetdijshme, moshë kur njeriu kërkon rrugën e jetës, vendin e vetë në jetë e në shoqëri. Të rinjtë sidomos kur janë në shkollë kërkojnë rrugët profesionale që do të ndjekin. Personaliteti njerzor në zhvillim përcakton «planet» e së ardhmes.

Në moshën 18 vjeçare të rinjtë e fitojnë të drejtën të zgjedhin. Në këtë moshë ata kanë të drejtë të vendosin për martesën, e cila është një ndër hapat më të rëndësishëm në jetën e tyre. Kjo moshë është e vendosur nga Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë dhe kërkohet të respektohet nga të gjithë besimtarët. Duke pasur parasysh tendencat e disave për t'i martuar vajzat në moshë të re, pa mbushur të 18 vjeç.

Martesa nuk është vetëm një ngjarje tepër e rëndësishme individuale në jetën e njeriut. Ajo ka edhe një domethenie në mbrendi të pasur shoqërore. Ajo hap rrugën për krijimin e familjes. Në të cilën çifti do të presë dhuratat e mrekudheshme që Zoti do ti dhurojë, këtu do të lindin e do të rriten fëmijët, dhe për këtë të rinjtë duhen të përgaditen për të si dhe për ngjarjet që do ti bashkëndajnë. Këtu hidhen themelet e një bashkimi të shëndoshtë, që do të zgjasë gjithë jetën. Në këtë periudhë të shkurtër të «rinisë së artë», i riu përbadhet me shumë ngjarje që sjellin me vete momentet për të vendosur për të gjithë jetën. A nuk është pikërisht kjo moshë që duhet të vendosin se ç'drejtim duhet ti japin jetës së tyre? Të vazhdojnë shkollën e lartë, po cilën degë? Të shkojnë në ushtri, e cila është një detyrë që na e kërkon kombi që ta krye-

jm? Të gjejnë një punë, po cilën, po ku të punoj, a mos vallë tani ka ardhur çasti për të marrë rrugët e botës se këtu nuk ka punë? Pra kjo është moshë që sjellë me vete udhëkryqet e saj për të cilat i riu duhet të vendos një herë e mire.

Prandaj kjo quhet e artë sepse flasin për bukurit e veçanta e të papërsëritëshme të kësaj moshe, për gjurmët e pashlyeshme

el më i lartë përgjegjësi. Spikat edhe prirja për qëndrimin meditativ filozofik ndaj dukurive të jetës. Kjo duket edhe në zgjedhjen e leximeve, sidomos në orjentimin nga veprat madhore. Zhvillohet edhe dëshira për debatin. Jeta bënë punën e vet. Edhe shkollimi. Sidomos i riu duke mësuar sistematikisht, i riu fiton pikëpamje të caktuara, të cilat duke i bërë të vetat, i kthen në bindje. Dhe ato të udhëheqin për veprim. Shkallë-shkallë ngrihet kështu një godinë e fortë dhe e qëndrueshme, bazat e një botëkuptimi, e një sistemi pikëpamjesh që të udhëheqin në jetë.

Në rininë e parë merr një shtytje të re

tjetër e medaljes për të rinjtë që nuk janë kërkuës ndaj vetës dhe të dal nga një adolishencë problematike e thellon edhe më shumë qëndrimin në rrjetet sociale. Kjo moshë kërkon në këto rrjete sociale shumë por duke mos qënë me këmbë në tokë se çfarë kërkojnë dhe ku do të arrijnë. Këto të rinjtë bëhen viktimë duke u përballur me dështime dhe degradime.

Në këtë moshë takojmë edhe ndryshimet në komunikimin e të rinjve me njerzit përrreth, ecin shumë përpara ndjenjat e shoqëris dhe të miqësis. Fara e hedhur në adolishencë jep frytet e para. Shtohen kërkesat ndaj shokëve, zhgënj-



që ajo lë në jetën e njeriut. Sepse pikërisht gjatë saj shperthen fuqishëm një potencial i pallogaritshëm njerzor me shumë vlera me mbrendinë shumë të pasur e me drejtime e kahje nga më të ndryshmet. Në fakt është moshë kur njeriu shpalos mundësit e tij dhe merr «bekimin» e parë jetësor. Kur duke u futur në pjekuri, tani ai bëhet «i madh» jo vetem nga të drejtat e detyrat, por edhe nga mundësit dhe fuqit, nga perjetimet etj. Le ti shohim pak më konkretisht disa nga më kryesoret.

Të fillojmë nga zhvillimi intelektual, nga veprimtaria njohese. Vërehet një niv-

të fuqishëm edhe zhvillimi i dispozitave e dhuntive, i aftësive dhe i prirjeve, madje edhe i talenteve që me shumë dashuri i ka gdhendur tek çdo i ri por në mënyra të ndryshme. Vërehet diferencimi i këtyre veçurive të rëndësishme të personalitetit njerzor, e ndonjë herë, edhe e qarta të individualizmit të tyre. Ndhimojnë vetë zhvillimet e disponimet moshore; zgjerimi e pasurimi i kërkesave shpirtërore; kalimi, krahas veprimtaris riprodhuese e imituese, edhe në atë krijuese. Diçitalizimi ka sjell shume favore për pasurimin intelektual të rinjve. Por fatkeqësisht ana e

met që sjellin shokët përjetohen shumë rëndë. Ndonjëherë në mënyrë dramatike. Midis shokëve shumë të ngushtë mund të lindin miqësi tepër të afërta dhe intime që mund të zgjasin gjithë jetën. Kur kjo ndodhë mes një djali dhe një vajze krejt natyrshëm, mund të rritet e të pasurohet edhe më tej, të kaloj në dashuri.

(Vazhdon në numrin e Ardhshëm)

**Roza Pjetri**

disa vite që në krye të Forumit Rinor Shqiptar e mori titullin «Pishtar i Demokracisë», ndër personalitetet e shquara të Nikaj-Merturit (sot punon në New York në një kompani e pozicion të vlerësuar). ( Shih F.Vukaj «Krenari për vendlindjen», Triptik për Nikaj-Merturin, Tiranë 2006).

Takimi në fjalë mbaroi pa ndonjë vendim, duke u anashkaluar mundësia e ndërhyrje së Gardës apo gjakderdhjes. Ky akt është i njohur dhe i vlerësuar shumë në atë kohë.

Ngjarjet politike rrjedhin shpejt dhe Gjelosh Ukcama në vitin 1991 do të niste punë në Drejtorinë e Kuadrit të Ministrisë së Brendshme.

Duke parë aftësitë profesionale e seriozitetin në punë, pas ardhjes në pushtet të Partisë Demokratike, me urdhër të Bashkim Koplikut, me të cilin ruajti gjith-

një marrëdhënie pune të shkëlqyera, do të emërohej nën/Drejtor i Kuadrit të Ministrisë së Brendshme.

Ai do të kryente një sërë reformash pozitive të rëndësishme për kohën dhe ndryshimet demokratike.

Në vitin 1993, emërohet Drejtor i Drejtorisë së Ruajtjes së Objekteve të Rëndësishme të Veçantë (D.R.O.V) pranë Gardës së Republikës dhe gradohet Nënkolonel.

Ai ishte dhe mbeti njëri nga kuadrot më të njohur dhe korrekt të strukturave drejtuese të Gardës së Republikës së Shqipërisë.

Gjelosh Ukcama largohet nga Shqipëria në vitin 1996 pasi fiton lotarinë amerikane dhe vendoset në New York së bashku me gruan Prendën, me fëmijët Elonën, Blerinën e djalin Kristi, një familje model për të cilin investoi shumë edhe kryefamiljari

që nuk jeton më.

E shoqja, një zonjë e nderuar, është e bija e të ndjerit Mark Ndoja nga Dukagjini, një punëtori të palodhur, i ndershëm e i drejtë, i cili përfaqësoi vlerat më pozitive të malësorëve. Për disa vite që ndër drejtuesit kryesorë të Shkodrës e deri Kryetar i Komitetit Ekzekutiv në Lushnje me arritje të mëdha e shumë respekt nga populli, por kjo ra ndesh me eprorët e tij egoistë, të paafte e të paditur.

Në SHBA, Gjeloshi ishte një përkrahës i zjarrtë i Kosovës dhe do të merrte pjesë në takime e veprimtari të shumta, të bënte gjithçka të mundshme për Pavarësinë e lirinë e saj; pa u kursyer, gjithnjë pranë patriotëve shqiptarë në mërgim.

Ai e nisi karrierën e tij në një moshe krejt djaloshe. Gjatë gjithë veprimtarisë së tij, në poste të rëndësishme në Tiranë e jashtë saj, para dhe pas rënies së sistemit,

Gjelosh Ukcama nuk krijoi asnjë armiqësi, nuk shkeli mbi dinjitetin e askujt dhe nuk la pas asnjë mbresë të keqe.

Përkundrazi, janë të njohura me dhjetëra raste e më shumë, që ka rrezikuar seriozisht karrierën e ndoshta edhe lirinë, në mbrojtje e respektim të personalitetit, të drejtave e lirisë së individit.

Në New York Gjelosh Ukcama ndërroi jetë në 27 Maj të vitit 2020 (si shkak i Pandemisë -Covid19) dhe u varros po në New York për t'u kujtuar e mos harruar ndër breza.

**Saint Genis Pouilly, Francë,  
16 Prill 2021**

**Frok Vukaj,  
Kryetar i Shoqatës  
«Akademia e Shkencave të Edukimit»,  
Tiranë**

# PËR HERË TË PARË NJË PRESIDENT SHQIPTAR NË SHTËPINË E DED GJON LULIT!

Me ftesë të pasardhësve të Heroit dhe Atdhetarit të shquar Ded Gjon Luli, komandantit të Kryengritjes së vitit 1911 të Malësisë së Madhe, si dhe të prof Lulash Palushaj, i vlerësuar me titullin “Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut”, ish Presidenti i Republikës së Shqipërisë, zoti Bujar Nishani, vizitoi me datën 7.05.2021 shtëpinë muze të Kryetrimt, e cila gjendet në Bardhaj të Hotit.

Edhe pse kjo shtëpi, në të cilën u lind dhe u rrit Heroi Legjendar Ded Gjon Luli, u dogj gjashtë herë nga serbo-malazezët, nuk arritën kurrësi të zhduknin rrënojat mbi të cilat hodhi shtat një pjesë e lavdishme e historisë së shqiptarëve.

Restaurimi i saj u bë në vitin 2006, përmes ndihmës së diasporës, dhe dy vite më parë u vendos edhe busti i Ded Gjon Lulit, kompozuar këmbë mbi këmbë, në hyrje të kullës, teksa duket se po prët vizitorë. E kësaj radhe bëhet fjalë për një ish President, i cili është dalluar për kontaktet e vazhdueshme edhe kur mbante një post të tillë, për vizitat në trojet shqipfolëse, që i kapërcenin kufijt zyrtarë të Shqipërisë.

Muzeu, edhe pse ka nevojë për t'u pasuruar, përcjell një emocion të fuqishëm për çdo visitor, që vjen nga afër apo nga larg prej këtu. Historia ka depërtuar në zemrën e çdo shqiptari, aq sa kur ai prek dëshmitë e historisë, ndjen mbi vete peshën e sakrificës së bërë në mbrojtje të trojeve amtare.

Po, përse u zgjodh ish presidenti Bujar Nishani për t'i bërë ftesën? Gjatë periudhës kur ai mbante postin e Presidentit të Shqipërisë, Malësia e Madhe u vlerësuar me titullin “Nderi i Kombit”. Gjithashtu, falë mbështetjes së Tij, u bë e mundur vendosja e shtatores së Ded Gjon Lulit, pranë Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë.

Ish Presidenti, shoqërohej nga bashkëshortja e tij, zonja Odeta Nishani; gjithashtu nga deputeti Gjokë Uldedaj me bashkëshorten e tij; përfaqësues të Ko-



munës së Tuzit; famulltarë, etj. Fjala e hapjes u mbajt nga Prof. Lulash Palushaj, i cili, pasi falenderoi Presidentin për vizitën, mes të tjerave solli një inkuadrim të historisë mes 24 Marsit dhe 6 Prillit të vitit 1911; vlerësoi rolin e jashtëzakonshëm të Ded Gjon Lulit në krye të Kryengritjes së Malësisë së Madhe, dhe rikërkoi që data 6 prill të shpallet si Festë Kombëtare.

Pas tij, fjalën e mori përfaqësuesi i Komunës së Tuzit, politikani Nikoll Camaj, i cili e vuri theksin tek përgjegjësia që duhet të kemi në përcjelljen e historisë tek brezat.

-Ishte koha që kishte nevojë për Her-

onj, - u shpreh ish Presidenti, zoti Bujar Nishani, në hyrje të fjalës së tij. - Nga të katër anët ishim të rrethuar me armiq, të tillë ndaj shqiptarëve dhe trojeve të tyre.

Ai e lidhi rolin e rezistencës dhe të Luftës që ka bërë Malësia e Madhe, si vendimtare në fatet e Shqipërisë, që nga Lidhja e Prizrenit e deri tek ngritja e flamurit në Vlorë. - Gjuha shqipe kurrë nuk u zhduk, - vijoi ish Presidenti. - Armiqtë e shqiptarëve e kanë ditur se nuk do mund t'i asgjesonin, as përmes dhunës, as përmes varfërisë, e as përmes izolimit. Por historia ka treguar se ata kanë përdorur përçarjen, copëtimin, asimilimin. E megjithatë, ky rrezik i madh nuk dha rezultate, sepse shembujt dhe burrat si Ded Gjon Luli, u bënë frymëzues dhe krijuan një rezistencë të madhe. Sot ne kemi përgjegjësinë për

të shkruar historinë, për ta mësuar, pasuruar dhe trashëguar atë tek fëmijët tanë. Ajo që është më e rëndësishmja, - tha ish Presidenti në përfundim të fjalës së tij, - është që të përiqemi për të nxjerrë në pah vlerat dhe egzistencën tonë.

Më tej, në nderim të vizitës së ish Presidentit Nishani, artistë të Shoqatës Kulturore e Atdhetare “Ded Gjon Luli” kënduan një këngë kushtuar Heroit Legjendar, Ded Gjo Luli.

Vizita e personaliteteve të tilla, merr një vlerë të jashtëzakonshme për shqiptarët, të cilët vazhdojnë të jetojnë ende në trojet e tyre përmes vështirësive të mëdha, të karakterit ekonomik, por edhe nga mosmbështetja e duhur nga strukturat shtetërore malazeze. Kurrfarë investimi nuk bëhet në trevat me përbërje të plotë shqiptare. Kjo i ka detyruar ata që të emigrojnë në Europë, por më shumë në SHBA. Konkretisht, para 50 viteve në fshatin Bardhaj numëroheshin 74 familje. Sot aty gjen vetëm 9 të tilla. Ose, shkolla “Bashkimi”, e cila grumbullon fëmijë të Hotit, para 49 viteve frekuentohej nga 347 nxënës, kurse sot gjen vetëm 51 nxënës. Ky fenomen është tejet i përhapur, sidomos në Mal të Zi. Faktori shqiptar, i pozicionuar në organet vendimmarrëse, është tepër i dobët, çka ka bërë që shqiptarët autoktonë në trojet e tyre, të trajtohen si pakica kombëtare. Nga ana tjetër, aktivitetet të tilla, mbahen në shënjestër nga qeveria malazeze, e cila, jo vetëm nuk çon asnjëherë përfaqësuesit e saj, qoftë edhe në aktivitetet kulturore, por nxjerr pengesa, apo dënon shqiptarët për flamurbajtje.

DERI KUR KËSHTU??!!

Pergatiti znj. **Kozeta Bruçi**

## JETË NË SHËRBBIM TË PYJEVE DHE MIDIS NJEREZVE

Në kujtim të Fejzi Zaganjorit

Përgatiti: ing. Gjon Fierza

Agjencia kombëtare e pyjeve, Tiranë

Sapo mora vesh lajmin e hidhur për ndarjen nga jeta të Fejzi Zaganjorit, qytetar me emër i nderuar i Shkodrës, një klerik i njohur në Shkodër dhe jo vetëm, ndjeva një keqardhje të madhe. Ai ishte në kulmin e kontributeve të tij si klerik pa harruar dhe atë të pylltarit pasionant. Përveç se një shërbëtorë i përkushtuar i fesë islame në gati 30 vite, ai gjithnjë

ishite në lidhje me pylltarët dhe pyjet, ai ndiqte dinamikën e këtij sektori. Ai gjithnjë ka demaskuar dëmtimin e pyjeve në këto vite, ndërkohë që ka ofruar dhe rrugëzgjidhje të problemave që lidheshin me to. Disa projekte të vogla të nisura se bashku lidhur me pyjet dhe personat që kanë punuar më to në vite në Shkodër, tashmë do ndërpriteshin. Unë kam pasur mundësinë që ta njoh që në mesin e viteve 70 si mësimdhënës në Shkollën e Mesme Pyjore Shkodër, më vonë si kolegë dhe

tashmë si një personalitet të shquar të predikimit dhe shërbimit të Besimit Islam në Shkodër.

*Nga zemra, në emër timin dhe shumë bashkëkohësve të mi pylltarë, shpreh ngushëllime familjes, miqve, kolegëve dhe të afërmeve të tij. Fejzi Zaganjori, zoti ta shpërbleftë me xhenet të gjithë punën tënde ndër vite. Në dekada punove pa u lodhur si pylltar, në shërbim të Islamit, të qytetarisë shkodrane dhe të ruajtjes dhe fuqizimit të vlerave të bashkëjetesës.*

Në këto ditë kur Fejzi Zaganjori tashmë fizikisht nuk është më midis nesh, po sjellë këtë letër të dërguar prej tij midis shumë komunikimesh që kishim së bashku. Është paraqitur prej tij shkurt puna dhe kontributi i tij në pyje dhe vetmas në zonën e Dukagjinit.

Është ky shkrim modest që paraqet dhe një dimension tjetër për vlerat dhe cilësitë e të ndjerit Fejzi Zaganjori, përveç se të një kleriku me shumë kontribute në predikime dhe me shumë botime dhe një veprimtar aktiv shoqëror. Pyjet ishin profesioni dhe pasioni të cilave ju kushtoj jetën aktive.

Letra është e pa redaktuar e shkruar dhe dërguar prej tij nga fund viti 2020.

I dashtun ish nshanësi jem Gjon Fierza. Në plotësim të kërkesës tanë për të përshkrue punën teme në pyje dhe kryesisht në Dukagjin po ju dërgoj këtë shkrim ..

Kam lindun prej dy prindëve të mirë e të drejtë e shumë atdhetar dhe dijen e kishin gjithmonë në plan të parë. Më kanë dhanë prioritet vazhdimisht që të mësoj, kjo më dha mundësinë që të vazhdoj

shkollën dhe të përfundoj Fakultetin e inxhinierisë pyjore. Falënderoj të Madhin ZOT që në fakultet kam pasë profesorë të aftë e të ditun që kanë dhanë kontribute të mëdha në shkencat pyjore si: profesor Lazar Treska e me rrallë profesorët Ilia Nako, Alaudin Frashëri, Dhimitër Jançe, Akile Pite, Izmini Nako, Skënder Fico, Panajot Koçi, e të tjerë.

Mbasi u diplomova, me datën 8 shtator 1969 fillova punën në Breg Lumit në Dukagjin që ishte lokalitet me 26 kooperativa bujqësore porsa ishin krijuar. Punën e fillova inxhinier dhe përgjegjës sektori. Dukagjini përbahej nga ekonomitë pyjore: Lugina e Kirit, e Shalës, Shoshit dhe Toplanës. Llojet pyjore janë nga ma të ndryshme mbasi janë dhe 4 zonat fitoklimatike. Deri në atë kohë nuk ka pasë inxhinier pyjesh në atë krahinë dhe si i pari që isha dhe shume punë filluan së pari. Masi u njoha me dokumentet e inventarizimit të vitit 1968 të pyjeve të asaj zone, iu përvësua terrenit që nuk mbet vend pa shkue e pothuaj nuk mbeti shtëpi pa shkue dhe më priten si djalin e tyne. Deri në atë kohë nuk ishte ba asnjë investim për pyjet në Dukagjin. Arrita që të filloj investimet e para në shkallëzim të gështenjave në Plan në Kodër Kujës, në mbjellje fidana gështenje në Ndreaj të Shoshit dhe në Kodrën Zeqiraj në Breg të Lumit. Populli u gëzue se filluen investime, mbasi deri atëherë mbjellshin gështenja me kontribut vullnetarë si në zonën e Pultit e të Shoshit. Në vitin 1970 u mora me një studim për Thethin i mbështetur në një studim të Simon Harapit dhe përfundova duke e dërgue në ministri dhe nuk dihet fati i tij sot e asaj dite. Në prill të këtij viti vjen urdhri me krijuar fidanishte pyjore me llojin pishë në Theth. Pranë stacionit pyjor në Theth ishin 2 dynym tokë taracë e mbjellun me kërtolla. Bisedoj me kooperativën dhe ma japin për fidanishte. Njerëzit vendas dhe disa teknik me thonë nuk ban dhe ka me të dështue, mbasi asht provue dhe ka dështue. Baj projektin se duhej nivelue e me ba terrace mbi terrace etj. Në të vertete literatura ruse qe kisha në dore tue përkthye thoshte se fidanishte pyjore me pishë te zeze nuk jep rezultat ne se mbjelljet ne toka ku prodhohet kërtolla dhe misri po ashtu kur asht në afërsi të pyjeve te ahut. Te tre këto ekzistonin pos të tjerave. Konsultohem me tekniket Sokol Çuni, Zef Fierza dhe Pjeter Lulashi, të cilët ishin ma të afte dhe kishin përvojë në atë zonë. Ata më dhanë shtytje dhe filloj puna. Kur erdh koha e mbjelljes për të marrë farën e pishës, kam shkue në Pukë në kamë prej Bregut Lumit e tue kalue Drinin me kamerdare makinat. Bana eksperiment një dynym e mbolla me teriçat dhe një dynym me direkt dhe'. Mbajllja me teriçat dha rezultat të pa besueshëm sa erdhën të organizuar kolektiva nga sktoret e tjerë për përvojë dhe arritjet e mira të këtij eksperimenti. Masi këto fidana që u banë standard, mbrenda vitit filluen investimet edhe në pyllzime me pishë te zeze dhe me gështenja një pjese të ardhuna nga Shkodra një pjese fidanave prej Xhanit dhe Shoshit. Kam mbjellë 10 ha në vitin e pare 1970 me pishë të zezë në Theth dhe 30 ha në Breg Lumit, 30 ha në Toplanë dhe 30 ha në Brijat e Xhanit. Po atë vit i kemi dhanë fidana për të mbjelle në Kodrat e Troshani, në Razëm

dhe në Dushkakuq në Vaun e Dejës. Çdo gja u ba mirë e me sukses. Është kënaqësi e madhe kur i sheh sot pishat e rritura që pak njerëz e dinë se ato janë mbjellë nga ata banorë të zonës. Mbajlljet e pishës dhe gështenjës vazhduan në vite në Dukagjin deri në fillim viteve 90. Në atë kohë, nga Bashkimet Profesionale të Shqypnisë erdhën dy fletë lavdërimi: njëra për Sektorin pyjor Dukagjin dhe tjetra për mue. Edhe pyllëzimet me gështenjë në Shosh, Kir, Pog, Mguillë e Plan, vazhduan me investime dhe pisha e zeze u shtrinë në Gjuraj dhe Xhan, këto punim realizoheshin nga kooperativat bujqësore që kërkonin dhe kishin shumë nevojë për investime. Pra pyjorja ju jepte investimet kryesore kooperativave në ato vite.

Kam nxjerrë teknike të mirë e të afte që janë shpërnda dhe kanë kontribue në gjithë Shqipëni. Kujtoj disa nxanësit në ato vite që sot nderojnë pylltarinë shqyp-tare si : Selmam Meziu nga Dibra, Gjon Fierza nga Dukagjini, Kleanthi Mandi nga Gjinokastra, Prend Bardhi nga Elbasani, Gjetë Doda nga Kruja, Halim Lala nga Dibra, Valter Xhahon nga Korça, Feti Gjoka nga Dibra, Ilirjan Gjika nga Vlona, etj. etj. Në teknikum kam krijuar, kabinetin e sivikulturës dhe kam përmirësue dhe shtue llojet në kabinetin e dendrologjisë, falë kjo mbasi çdo nxanës nga zona ku jetonte biente llojet e rralla pyjore që rriteshin në zonat e tyne.

Në vitin 1978 kalova përsëri në Ndërmarrjen pyjore Shkodër dhe pavarësisht

gjithë Shqypninë. Më ka shërbye edhe një literaturë që me ka ardhë direkt në shtëpi si për skemat për ripërtëritjen me premje të nëndheshme, e të tjera. Kam marrë pjesë në studimin e përhapjes te bimëve medicinale në shkallë rrethi dhe krijimin e reparteve të bimëve pranë ndërmarrjes për eksport. Jam pengue për të shkue në Austri dhe në Rumani për shelgun. Jam pengue për drejtor ndërmarrje në vitin 1973 dhe në vitin 1998. Ishin këto paradokse të kohës që duhet ti pranojmë, se nuk merrnim atë që na takonte apo meritonim. Me 1990 kam shkue në sektorin Vau- Dejës inxhinier e përgjegjës sektori ashtu siç isha për bimët eterovajore e medicinale dhe shelgun mbasi këto shkrinë. Në Vau - Dejës kam punue 17 vjet. Gjatë



Ish pedagoget Fejzi Zaganjori dhe Emi Ura, me nxanësit e matures 1976 te Shkolles Mesme pyjore Shkoder. Takimi pas 40 vitesh Tirane 2016



Mbas Dukagjinit kam ardhë në sektorin Mes- Shllak, veprimtaria nuk ka kenë e dendun mbasi ishte fidanishta e krijueme objektet e pyllëzimit po ashtu ishte vazhdimësi. Dua të shtoj që në Dukagjin është punue me shumë kujdes në përmirësimin e pyjeve të lisit dhe frashnit sidomos në pyll të Shoshit, në Preçaj të Xhanit, ku rezultatet kanë qene të kënaqëshme. Sot ato dushkaja kanë marrë zhvillim të mirë.

Nga sektori Mesi jam transferue dhe për 5 vjet kam punue si pedagog në Teknikumin Pyjor të Shkodrës, një shkollë e rëndësishme dhe nxirrte çdo vit teknikë të mesëm pyjesh që punonin në gjithë Shqipëni. E them me bindje se landet e specialitetit u jepeshin nxanësve nga inxhinieret me nivel mësimdhënie të naltë dhe të gërshetuara me shumë praktika në terren. Unë, kam dhanë mësim në lendet: dendrologji, silvikulturen të dy pjesët dhe mbareshttrim pyjesh. Këto ishin dhe lëndët bazë të shkollës.

punëve të tjera si me pyllzime, mbrojtje, e të tjera, unë u ngarkova dhe me bimët mjekësore. Nga ministria në atë kohë iu dha randësi bimëve medicinale, eterovajore, shelgut, e të tjera. Në teknikum kisha mbajttë një temë shkencore për bimët dhe kjo dha shtytje që ti ndjek më tej ato. Pa u zgjat, gjatë kësaj koha kam ba projekte pyllëzimi të shelgut gjatë Bregut të liqenit, në zonën e Oblikes dhe Dajçit. Kam ba studimin e përhapjes së shelgut në rrethin e Shkodrës tu përcaktue jo vetëm llojet por dhe sasinë e prodhimit për ha dhe masat për shtimin e prodhimit si sasi dhe cilësi për të shtue fuqinë punëtore në Ndërmarrjen e zunkthave, studim që u miratue dhe vazhdoj deri sa u mbyll Ndërmarrja zukthit, mbasi kisha parashikue deri në viti 2005. Kam ba studimin për kultivimin e shelgut bishtdhelpën dhe fletëpjeshkë dhe rendimenti ka kenë i naltë dhe me urdhën nga qeveria kemi prodhue e shpernda me miliona kelema në të

kësaj kohe iu kushtue randësi mbjelljes se fidanave me pishë, dhe punimeve të tjera si dhe kryesisht mbrojtjes. Kam ba projektin e përmirësimit të pyjeve të pishave në Vig - Mnelë e të tjera. Një vit para se të dilja në pension me dëshirë kërkova transferim ta mbyll jetën aktive në profesion në zonën e Dukagjinit pasi atje e fillova punë dhe kjo kërkese mu plotësua. Pra puna ime si pylltar filloj dhe mbaroj në Dukagjin, në gati 40 vite duke punuar në gjitha pyjet e Shkodrës dhe jo vetëm. Me kënaqësi e shpreh se për mue pyjet dhe njerëzit e zonës Dukagjinit zanë një vend të veçantë. Për ata njerëz shumë prej të cilëve i kam miq dhe sot, kam respekt e mirënjohje të veçantë. I kanë dashtë dhe mbrojtje pyjet e tyne. Ka mirëpritur pylltarët në shtëpitë e tyre në çdo kohë.

Janë shumë punë dhe kujtime që me ulë me shkruar gjatë, nuk dalin disa fletore e duhen disa ditë e muaj. Por unë jam përpjekë me i përmbledhë se due me të shkruar ma vonë dhe për personat e veçantë që kanë punue me sektorin e pyjeve në Dukagjin dhe në Pyjoren e Shkodrës. Këtë kërkese tanen do përpiqem me ta plotësue sa më shpejt.

I dashtun Gjon, tu përfundue due me ta theksue: kemi punue tue pasë dëshmitar të Madhin ZOT, kemi punue me dashni ndaj profesionit të pylltarit dhe kemi punue me përkushtim për Shqypninë tonë.

Me respekt e dashamirësi, ish mësuesi yt Fejzi Zaganjori (Idhza).

Shkodër, 5.11.2020

# Kulla e Mark Sokolit të Dedajve të Shkrelit

Prof. Gjon Frani Ivezaj

Për të kuptuar zanafillën e qëndresës dhe virtyteve të shenjta të malësoreve duhet të depërtojmë thellë në rrënjët e tyre dhe lidhjet e gjakut të cilat e bëjnë këtë krahinë të lidhur ngushtë si “trupin e gjallë me shpirtin e tij”.

Këto virtyte të lashta sa vetë jeta e përtërimë në këto troje kanë dëshmuar dhe nxjerr në pah Kulla me zë e malësor fisnik që u kanë bërë ballë çdo shtrëngate duke i dhanë lavd e nder fisit e Maleve të Malësisë së Madhe.

E tillë ishte edhe Kulla e Mark Sokolit të Dedajve të Shkrelit, e cila pati zë për nga besa e burrnia e trimave që rriti, e nder e bujari nga pritja e grave fisnike të marruar ndër kullat ma të fisshme të Malësisë së Madhe, ku mund të thuhet se, janë pikërisht këto virtyte e tradita që i bënin këto fise aq të ndërlidhura me njëra tjetrën sa, sa herë që lëshohej kushtrimi, nuk vononin të mblidheshin malësorët si bletët pranë Ulanikut (lëmit të bletëve), sidomos në kohët ma të vështira kur kushtrimi për luftë tunde malet e zgjonte egërsinë e shpirtit të trimave malësor me mbrojtje trojet e veta nga pushtuesit e huaj. Sa i takon rrënjëve të hershme të kësaj Kulle apo dritë-hijeve mbi të dhënat e shkruara historike të fisit të Shkrelit mund të themi se janë krejt të vakëta dhe empirike për ta dëshmuar shkencërisht rrjedhën historike të zhvillimit social të këtij fisi, ama ka plot këngë, gojëdhëna e fakte që dëshmojnë lashtësinë e këtij vendbanimi, siç janë gjetjet arkeologjike apo edhe prezencat e objekteve të kultit të tipit bazilika, që i përkasin periudhës më të hershme të besimit paleokristjan. Për këtë fis kanë shkruar shumë kronikan të kohës si Franc Nopça, Edit Durham e deri edhe pushtuesit të cilët në dorëshkrimet e tyre pasqyronin rebelimin e këtyre banorëve të pabindur ndaj sundimit të tyre. Me shumë vlerë janë dhe mbeten relacionet e kishës ku klerikët në shërbesë, pasqyronin vazhdimisht qëndrimin e këtyre banorëve si besimtar dhe bashkësisë njaft me dinjitet në jetën e tyre të përditshme të cilët e personifikonin si “kodi i mirësjelljes për faqe të shekullit”, që në vërtetë, për nga mirësjellja dhe virtytet e larta njerëzore malësorët nuk bënin shumë dallime pasi kodi i maleve ishte tepër i shenjtë për ta, ndaj i bindeshin të gjithë pa përjashtim. E vetmja gjë që bënte dallimin ishte qëndre-

sa e palëkundur e kullave dhe përballja e banoreve të saj me disfatat apo armikun e pabesë sikurse edhe Kulla e Mark Sokolit të Dedajve në Shkrel. E njohur në Malësi për bujari, për tradita dhe për bijtë e saj të devotshëm në mbrojtjen e trojeve të Malësisë, ku u linden dhe u rriten krenar breza të tërë me faqe t’ bardh, u pikas si ajo rrezja e diellit që verboi sytë gjakatar të diktatorit komunist Enver Hoxha i ardhur në pushtet në nëntor të vitit 1944. E shenjësroi këtë Kullë duke dhënë urdhër të prerë që të digjej e të shkrumbohej së bashku me kullën e Kolë Tomës, si dhe të pushkatohej edhe dy djem të ri, Mirash Gjoni dhe Pjeter Kola, kushërinj të afërt të Markut. Si të mos mjaftohej me kaq Enver Hoxha u dha urdhër mëkëmbësve

të vjetër fare pranë Kullës, tashmë të shkëmbuar, megjithëse edhe aty të vëzhguar nga sigurimi i shtetit, i cili ishte i dhënë për t’ a mpiksuar dhe zhveshur malësorin nga traditat dhe virtytet e tij më të shenjta. Nga ana tjetër gjatë ditëve te tij të burgimit Mark Sokoli takohet me një mik buke dhe zemre, të cilit i kishte shpëtuar edhe jetën. Ai me grada oficer i lartë sapo e takoi Markun në burg, menjëherë ndërhyri duke lajmëruar zyrën e Shkodrës dhe shfajësuar Markun si njeri me dinjitet të lartë dhe vlera njerëzore. Për t’ i siguruar xhelatët e Shkodrës, Ai u mbajti një qëndrim të prerë për faktin se Markut i kishte borxh jetën. Menjëherë pas kësaj ndërhyrje Mark Sokoli lirohet mbas 3 viteve dhe i bashkohet familjes së tij.

mentet si azilant, të katër djemtë e Prek Markut emigruan drejt SHBA. Pas arratisjes së fëmijëve, familja e Prek Markut internohet nga sigurimi i shtetit dhe vendosen në Hajmel të Shkodrës në vitin 1989, ku jetoj deri në rënien e sistemit komunist në vitin 1990. Menjëherë pas çlirimit nga kjo zgjedhë barbare familja e Prek Sokolit kthehet në Dedaj të Shkrelit pranë shtëpisë së tyre. Me tu sistemuar dhe kthyer në normalitet Prek Marku organizoi një darke festive për të falënderuar Zotin që ja mbërrini kësaj dite me u kthye pranë shtëpisë së tij zemër plot, tujë e dite se dhe djemtë e tij kishin mbërritur shëndosh e mirë në Amerikë. Në këtë darkë ftoi të gjithë miqtë, kushërinjtë dhe kumbarët e tij të cilët i kishte dëshiruar



Djemtë e Prek Markut: Tonini, Paulini, Pjetri dhe Fredi

të tij gjakatar, ta arrestojnë edhe të zotin e Kullës Mark Sokolin, bashke me të birin e tij Gjekën, të cilët i dënojnë me burgim, Markun me 20 vjet kurse te birin me 6 muaj heqje lirie. Me djegjen e Kullës dhe burgosjen e Markut me djalë, Gjekën, nisi edhe kalvari i vuajtjeve të kësaj familje, tashmë të mbetur në qiell të hapur dhe pa një strehë. E etiketuar si “familje e deklaruar” e zhveshur dhe privuar nga shumë të drejta morale e ligjore, pa mundur ti bëjë ballë kësaj shtypje dhe përbuzje sociale, dhe, me atë shpirtmadhësinë e saj për të mos i dëmtuar malësorët e tjerë, kjo familje detyrohet të mënjanohet prej gjithkujt dhe të nëndosjet në një kasolle

Edhe pse në kushte jo të mira ekonomike dhe në një banesë që më së shumti i ngjante një kasolleje, familja e Marka Sokolit me martesën e djemve, Gjekës dhe Prekës u shtuan e u shumuan sa në gjirin e saj po rriteshin 21

fëmijë. Me t’ u më kamur dhe rritur pak fëmijët, djali i vogël i Markut, Prek Marku, nisi të ndërtojë pranë themeleve të Kullës së tyre moçme një shtëpi të re banimi për të 11 fëmijët e tij ku me gjithë vështirësitë dhe skamjen e asaj kohe, shtatë prej tyre arriti ti martoje në Malësi. Me kohën u rritën edhe kërkesat dhe largpamësia e fëmijëve ku të katër djemtë e tij të vegjël Tonini, Paulini, Pjerini dhe Fredi, arratisen në maj të vitit 1989, duke thyer kështu kufirin diku lart në bjeshkët e Kelmendit dhe hyre në tokën Sllave, nga ku kërkuan azil politik pranë Ambasadës Amerikane të Akredituar në Jugosllavi të cilët e fituan pas një pritje prej nëntë muajsh në Beograd, tejet të sflitur nga punët e rënda fizike për të fituar një kafshatë buke për të mbijetuar, e duke fjetur si mos më keq nëpër kampet e përqendrimit. Sapo morën doku-



SHTEPIA E PREK MARKUT

prej kohësh me i pa e me bisedua me ta. I gjendur në ballë të trevezes mori gotën dhe për herë të parë në derën e tij, lëvdon Krishtin si asht zakoni ndër malësorët e besimit katolik. Në atë entuziazëm e me zemër plot prej ati çlirimi vuajtjesh Prek Marku u drejtohet miqve me fjalët: “me kto t’ mira që mi plotsoi Zoti në zemër edhe me deke sot me duket veti si me le”. Ishin këto edhe fjalët e lamtumirës pasi një javë më vonë mbylli sytë pranë shtëpisë së tij djali i vogël i Mark Sokolit, Prek Marku, duke lanë mbrapa mallë, mërzi e kujtime që peshuan rëndë mbi shpatullat e tij të fshikulluam më së shumti prej brenave të diktaturës së mbrapsht të komunizmit gjakpirës. Prek Mark Sokoli ishte i pari malësor që u përcoll për në banesën e fundit me Kryq e Krishtit që prej vitit 1967 në Shkrel e ndoshta edhe në Malësi. Pak kohë më vonë djemtë e Prekës marrin nënshtetësinë Amerikane ku menjëherë u bëjnë dokumentet fillimisht nënës dhe pastaj pjesës tjetër të familjes duke i bashkuar të gjithë në tokën e premtuar. Edhe pse arritën të bashkohen e të krijojnë një jetesë të mirë në Amerikë, mallin dhe dashurinë e kanë të pashuarë për Kullën, për vendlindjen e për varret e t’ parëve të cilët prehen si pishtarë për të dëshmuar rrënjët dhe qëndresën e tyre heroike si bij të denjë të Malësisë. Te mërguar e larg vendlindjes së tyre, të bijtë e Prek Mark Sokolit, kanë ditur të ruajnë traditat dhe zakonet e malësorit, atdhedashurinë e flakte të ushqyer me mallin e vatrës. Ata e shprehin ndër breza në mirë edukim, në kontribute nëpërmjet shoqatave e deri me bujarinë humanitare për nevojat e Kishës, Malësisë, e të shqiptareve kudo ku lind nevoja në trojet shqiptare.



MARK SOKOLI



GJEK MARKU



PREK MARKU

# NDOKË SINISHTA

Ditën e shtunë me datë 15 maj 2021, rreth orës 22 e 40 minuta, në një spital të Zvicrës ka ndërrue jetë Ndok Sinishtaj, mbas një sëmundje të rëndë.

## Biografia

Nokë (Ndue) Sinishtaj është lindur më 24 gusht 1944, në fshatin Kshevë të fisit Gruda të Malësisë së Madhe, në Malin e Zi, rreth 7 km larg qytetit të Tuzit, në një familje të madhe patriarkale me mbi 60 anëtarë. Ishte i katërti prej trembwdh-

shkonin njëherazi në shkollën fillore në fshatin e tij të lindjes, Kshevë, ndërsa arsimin tetëvjeçar e mbaroi në qytezën e Tuzit. Ndoka vazhdoi mësimet në Gjimnazin Klasik në Zara dhe Pazin (Ister) të Kroacisë. Vazhdoi studimet e larta për filozofi, teologji dhe letërsi në Rijekë, Zagreb dhe Firence.

I pajisur me kulturë europiane dhe njohës i pesë gjuhëve të huaja, Ndoka u shugurua meshtar dhe punoi pesë vjet në

1981.

I pa bindur ndaj eprorëve të vet për mënyrën si ata shërbenin, i kërkoi Papës lirin e tij nga detyra, por u mbeti besnik i bindjeve të tij si i krishterë. Me dekret të veçantë, Papa Gjon Pali II, lëshoi urdhërin për lirin e tij. Shkoi për banim në Zvicër, ku u martua me Znj. Rozmarin Huwiler Sinishtaj, me kombësi gjermane, me të cilën pati dy fëmijë: Djalin Benjaminin dhe vajzën Suzanën.

Si njohës shumë i mirë i disa gjuhëve, ai punoi për një kohë të gjatë si përkthyes në gjykatat e shtetit zviceran. Gjatë kësaj kohe pati njohje me figura të rëndësishme të studimeve albanologjike në Shqipëri dhe në diasporë. Është e njohur miqësia dhe korrespondenca me intelektualin e shquar Martin Camaj, me të cilin bashkëpunoi gjatë në përpjekjet e tij për lëvrimin e gegnishtes, si pjesë e vokacionit të tij intelektual.

Noka botoi libra me poezi dhe prozë në gjuhët shqipe, serbokroate, italiane dhe gjermane. Gjithashtu, ka shkruar vepra në prozë dhe në poezi në dialektin gegënisht dhe në të folurën e Kshevës së tij. Librat janë të pajisur me shënime dhe përmbajtje të shpjegime të shumta.

Varrimi, simbas amanetit që ai ka lanë me shkrim, u ba në Zvicër ku kaloi pjesën më aktive të jetës së tij.

Vepra

### Vepra në gjuhën Shqipe:

"Mogilat e Kshevës" (1976)

"Te varret e Kshevës", poezi (1976)

"Syri i ngujuar", poezi (1998)

"Në vend të epitafit", poezi (2002)

"I vetmuar, në kopshtin tim, qaj për të afërmit e mi", (2002)

"Spirale", poezi (2003)

"Rekuiem për fshatin tim", poezi (2005)

"Tetë letra të Martin Camaj", (2000)

"Nga sergjëni i harruar", poezi (2007)

"Rrefimet e një prifti të rebeluar", publicist (2000)

"Kupa e thyer e heshtjes", poezi (2010)

"Nën arkada të universit", poezi (2013)

"Dejka Kujtimesh", poezi, Tiranë 2014

"Cui Bono" kritikë, Tiranë 2016

"Monologu i Çinisë së Podgoricës", poezi, Tiranë 2016

"Shqiponja e Grudës Gjekë Gjon Sinishtaj 1894-1938, monografi, Tiranë 2016

"Motive Malësore" poezi, Tiranë 2017

"Ashti i Poetit", poezi, Shkodër 2020

Veprat në gjuhën Kroate:

"More mira u nemiru" ("Deti i paqës në trazim"), poem (1974)

"Nerastoceni mir" ("Qetësia e patrazuar"), poem (1974)

"Dubrovnik", poem (1974)

"Apokalipsa Paska s Prokletia", novel (1977)

Veprat në gjuhën Italiane:

"Rimani amica", poezi (1977)

Vepra në gjuhën Gjermane:

"Eingewickelt in sein Schweisstuch", poezi (1994)

Materiali është përgatitur nga Mark Palnikaj, Tiranë 2021 për publikim zyrtar.



Dr. Mark Palnikaj



jetë fëmijë të prindërve Gjellosh Toma dhe Age Uci.

Ndoka u rrit me shumë bashkëmoshatarë brenda familjes së tij të madhe, ku tridhjetë e tre fëmijë nga kjo familje

Guci, Tuz, Titograd (Podgoricë) dhe Tra-boin (Hot). Nuk u mjaftua me arritjet e tij në studime dhe në vitin 1975 u regjistrua në Filozofi dhe Letërsi Italiane në Universitetin e Friburgut, ku u diplomua në vitin



# ZEF MALA, PËR GJERGJ FISHTEN DHE GJUHËN SHQIPE (VITI 1955)

(vijon nga numri i kaluar)

Për këtë aktivitet të vjetër pata marrë nga regjimi i kohës, dënime të shumta me burgime e internime duke pësuar edhe gjyftime fizike të randa. Mbas vitit '41 e mbas kthimit tim në Shqipëri i kam ndejë larg çdo veprimtarie politike e shoqërore dukë u tërheqë në një kohë studimesh e meditacioni, me gjithë ftesat që më qenë ba nga Partia Komuniste për t'u integruar në të dhe për të marrë funksione përgjegjësie në organet e pushtetit të ri. Për këtë qëndrim qeshë edhe akuzue e goditë për obstruksionizëm ndaj sistemit në fuqi, bile edhe në vitin 1953 para ultimatumit me zgjedhë midis përgjegjësive dhe luftës së pareshtur që do të më bahej nga ana e partisë, i preferova t'i përballoj pasojat e kësaj lufte të pabarabartë si dhe rrjedhimet e një persekucioni të vazhdueshëm me dënime të përsëritura që po vuaj deri më sot. Kështu vargu i dënimeve të vjetra iu shtuen persekutimet, torturat, burgjet, internimet dhe gjykimet fizike të reja. Për aktivitetin e kryem nga unë deri në periudhën para vitit 1941 si dhe për mendimet e opsionet e mia pas kësaj periudhe regjimit e ndryshme që u përshkuan në vendin tonë, Monarkia, Komunizmi, më kanë ngarkue deri tani me 10 dënime për një shumë komplekse prej 60 vjetësh, burgime e internime nga të cilat 23 vjet po i kryej tani duke më detyruar të kaloj pjesën ma të madhe të jetës time aktive në kushtet që nënkupton privimin e lirisë nën pushtetin diktatorial, fajtor vetëm se desha lirinë e demokracinë për vendin e popullin tim e për vendet e popujt e gjithë botës. Kuptohet lehtëzi se unë nuk mund të aderoj në partinë Komuniste për shkak të rezervave që pata lidhur me linjën e saj me kompozicionin sodal me metodat dhe objektivat që ajo synonte, duke i gjykuar qëndrimet e qëllimet e saj politike, si të papajtueshme me idealin e asaj lirie që pat inspirue veprën time e mendimin tim të dikurshëm dhe të papërshtatshëm me interesat e kombit dhe të atdheut tim.

Ngjarjet e ndodhura në Shqipëri dhe nën kampin Socialist, mjafton të përmend ftesat për divizione të huaja me posedue territorin Shqiptar. Kërcënimet Hrushoviane nga toka Shqiptare kundër fqinjët jugor, edicioni Shqiptar i revolucionit kulturor Maoist si dhe kthesat e pendimet e vazhdueshme të Partisë, janë prova ma evidente e afermadonit të masipërm se ndikimeve të huaja nuk i kanë shërbye kauzës së pavarësisë të vendit. Për ma tepër në qoftë se në rininë time të parë, sentimentalizmi e fanatizmi djaloshar më patën shtyrë me përçafue idetë luftarake të lëvizjes Komuniste ndërkombëtare, si udhën e vetme për të përmbushë aspiratat e popujve për liri, barazi, drejtësi sociale e progres të përgjithshëm, pjekunia e mendimit në një moshë ma të shtyme

me studimet e mia në këtë ndërkohë më patën prirë tashma drejt një socializmi demokratik e liberal, humanist e kritik, si udhë e domosdoshme për të siguruar atë liri e drejtësi sociale pa të cilën asnjë shoqni njerëzore nuk mundet të ndërtohet e të përparojë, sepse në qoftë se liria nuk mund të ekzistojë efektivisht dhe të realizohet veçse mbi bazën e drejtësisë shoqërore, shprehja ma e lartë e së cilës asht rendi i Demokracisë Socialiste, vetë socializmi nuk mund të ekzistojë, veçse i mbështetur mbi një rend lirie të afirmuar



Zef Mala, Drejtor i parë i Arkivit të Shtetit, 1949-1952

në të gjitha format të cilat kjo artikulohet dhe merr konsistencën reale, d.m.th. si liri mendimi e ndërgjegje, si liri qytetare e politike, si liri njerëzore e individuale.

Kur isha i internue në Zvërnec, i pata drejtue autoriteteve shtetërore një letër proteste në të cilin shfaqja besimin që ishte njëkohësisht ma tepër një sugjerim, se dhe një sistem diktatorial komunist do të duhej që njerëzit të mundnin me jetue të lirë me mendimet e me opinionet e tyre duke garantue me ligj paprekshmërinë e integritetin fizik, intelektual e moral të çdo qytetari që nuk merr pjesë aktive në jetën politike të vendit të vet dhe që ku-

fizohet të respektojë ligjet në fuqi.

Unë, për veten time i jam përmbajtur determinacionit të maparshëm, për të mos u përzierë në veprimtari politike e shoqërore duke reduktue marrëdhëniet e mia në rrethin ma të ngushtë familjar i cili për fat nuk posedon as përgatitjen e nevojshme arsimore, për të ndjekë shtjellimin e mendimit tim politik. ' Bile as nuk kam reague kundër sulmeve e denigrimit që më bahet nga çdo anë në mënyrë zyrtare e jo zyrtare.

Sot mbas dënimit të fundit mue, që në

të cilit duhet të mbrohem me të gjitha mjetet legale duke i ba apel ligjeve njerëzore e tagrit natyral si qenie e si person. Gjatë vuetjeve së dënimit për nevojat e jetës do të jem i detyruar të mbaj me administratën atë lloj raportesh që çdo i burgosur mban me autoritetet e burgut ku vuen dënimin.

Mbas 5 vjetësh, në mbarim të dënimit kërkoj të më dorzohen instrumentat për largimin tim familjar nga Shqipëria. Në moshën 70 vjeçare dhe me shkopin e verbërisë në dorë, së bashku me shoqen e vuajtjeve të mia do të marr rrugët e mërgimit dhe të kërkoj një atdhe të dytë në ato vende ku revolucionet liberale e tradicionale kanë konsakruar tashma përfundimisht mundësinë e tagrit e çdo njeriut që të rrojë i lirë me mendimet e veta me kredon e vet filozofike e morale, sociale e politike

75 vite me pare kur Zef Mala, si drejtor i Bibliotekës dhe Muzeut Kombëtar do ti dërgonte letër Ministrisë e Arsimit.

REPUBLIKA POPULLORE  
E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E  
ARËSIMIT

BIBLIOTEKA KOMBËTARE E  
MUZEUMI  
Nr 175

MINISTRISË S'ARËSIMIT  
(Sekretariatit)

Këtu

Promemorie mbi nevojat, punën e perspektivat e Bibliotekës dhe të Muzeut Kombëtar

Sikurse kemi përmendë në shkresën e parë No 170, dt. 29-III-46 drejtue asaj Ministri, Biblioteka dhe Muzeumi Kombëtar gjatë kohëve të fundit kanë pësue ndryshime të randësishme, Biblioteka asht shtue e pasunue shumë me grumbullimin e librave të rekonarëve e të tjerëve, në sa Muzeumi asht damtue randë nga pushtimi italian. Tash një vjetë e te kndej po procedohet në riorganizimin e tyne, por për shkak mungesash teknike dhe personeli puna ka qenë mjaftë e ngadalshme.

Rregullimi i Bibliotekës dhe i Muzeumit asht i lidhur ngusht me përmbushjen e disa nevojave të domosdoshme që po rendojmë këtu poshtë:

A) 1. Raftë. Nga afro 100.000 volume që disponon sot Bib. Komb. vetëm 1/3 asht rendue, rregjistruar e katalogue, tuej u vuen në këtë mënyrë në shërbim të lexuesve. 2/3 janë grumbullue, dhe për t'i regullue e regjistruar këta nevojitet pikë së pari kryemja e rafteve. Të gjithë raftet e vjetër të Bibliotekës ka qenë nevoja

me i dyfishue në naltësi, ka qenë nevoja edhe me ndërtue rafta të rij që janë krye me mjete të rastit. Deri tani kemi marrë një herë 3m3 e një herë 3,6 m3 nga sharra Shtetnore e raftet janë punue vullnetarisht nga kujdestarët e kësaj Biblioteke me punë jashtë orarit e pa asnjë shpërblim. Sot, për të muejt me çue në kambë librat e Lumo Skendos, që përbajnë një pasuni të paçmueshme për Bibliotekën t'onë Kombëtare, nevojiten rafta për një sipërfaqe 220 m2 baras me 6 m3 drasë 3/4 dhe binarë 4 m. të gjatë. Zdrukthimin e tyne kish me qenë mirë t'a kryente Shkolla Tenike që ka zdrukthe me motor; se për bamjen e vendosjen e raftave, këtë mund t'a kryejnë këtu në Bibliotekë me punë vullnetare të personelit së përpara. 6 m3 dhe transporti i tyne vjen të kushtojë rreth 12000 fr. e me këtë shpenzim të vetëm mund të plotësojmë me rafta të gjitha dhomat e sipërme të godinës dhe të vendosim definitivisht shumicën e librave që disponojmë tani.

Pa u krye raftat nuk mund të procedohet në regjistrimin dhe katalogimin e librave.

2. Rregullimi i Muzeumit asht shtyer deri tani nga mungesa e sallave dhe e dollapëve të nevojshëm për t'ekspozue e për të ruejtë visarat t'ona arkeologjike.

Me plotësimin e rafteve të Bibliotekës, tuj u-ngjijtë shumica e librave nalt, poshtë shumë dhoma vijnë dhe mbeten të lira dhe kështu Muzeumi ka mundësi të zgjenohet e të ekspozohet për tani në tri salla të mëdha.

Për dollapet që i nevojiten Muzeumit, për pjesën ethnike (kostume etj.) mund të përdoren nja 20 dollape që disponojmë sot, të cilëve mjafton t'u heqim kapakët prej kompensati dhe t'i zevendësojmë me xhama. Për këtë ndryshim, për 20 dollape do të mjaftonin 3000 fr. Sa për vitrinat e nevojshme me ekspozue sendet e vogla arkeologjike numismatikën, hë për hë do të mjaftojshin 3 vetrina-rafta që mund të punohen fare mirë e lehtë në Shkollën Teknike.

Pa u-plotësue dollapet e vitrinat, asht e pa-mundun me ekspozue Muzeumin dhe me ba inventarin e hollësishëm që mungon krejtësisht. Nga mungesa e një inventari, jo vetëm sot nuk dijmë se ç'ka gjindet në Muzeum por edhe nuk mund të nxjerrim me saktësi se sa na janë grabitë nga italianet e çue në Muzeumin e tyne Kombëtarë e nga ana tjetër nuk kemi asnjë garanti për prishjet dhe humbjet eventuale.

3. Hapja e një sale leximi. Pjesa ma e madhe e lexuesve që frekuentojnë Bibliotekën janë studenta që kanë nevojë të bajnë mësim kolektiv, e prandej edhe mjaft shumë. Para disa kohësh kemi rrëxue një perde dhe krijue kështu një salle leximi të madhe poshtë. Salla tani ka nevojë të pastrohet, dhe t'i bahen rouletat e rij, që vijnë të kushtojnë 3000 fr. Nga ana tjetër numuri i frekuentuesve asht aqë i madh sa n'a mbasdreke 20 – 30 veta mbeten në kambë tuj pritë të lirohet nonji vend. Nga Ministria e Kulturës patëm kërkuje e nxjerrë auktorizimin për blemjen e 50 karrikeve, por mbyllja e buxhetit e kalimi i Bibliotekës e i Muzeumit nën mvarësinë e Ministrisë s'Arsimit, na detyroj që të mos i blejmë. 50 karrike vijnë të kushtojnë

5000 fr. mobiljet tjera, tryeza, rafta, etj për sallën e studimit poshtë i kemi.

4. Perdet. Të gjitha dritaret e fasadës rrahën vazhdimisht nga dielli që prej orës 10.30 të mëngjesit e deri në mramje. Drita e fortë e të nxehtit janë të padurueshme për nëpunësit e për lexuesit, dhe nga ana tjetër po damtojnë randë mobiljet e librat. Në Bibliotekë na nevojiten për 12 dritare të mëdha 4-6 kapakësh të fasadës afro 240 m. pëlhurë (beze) e bardhë ose ngjyrë kreme, që nuk lejon diellin me hye, por që nuk pengon as dritën. Kjo vjen të kushtojë rreth 7000 fr. Ndofta dyqanet Shtetnore mund ta furnizojnë edhe ma lirë.

5. Hekurat etj. Dritaret e poshtëme të fasadës së mbrapme janë krejtë të ulta dhe të pasigurta nga vjedhja eventuale. Kemi ba hekurat për dy dritare, por asht e nevojshme me forcue me hekura edhe një dritare të madhe të mesit, për një peshë 140 kg. e që vjen të kushtojë 1400 fr.

Përveç këtyne janë edhe disa meremetime të vogla që mund të kryhen me pakë qindra fr. ( si bravat e disa dyerve e rafteve, rregullimi i ujit etj.).

Me plotësimin e këtyne nevojave Biblioteka e Muzeumi rregullohen e sigurohen një herë e për gjithënjë dhe pajisen si ç'i ka hije një Bibliotekës Kombëtare.

B. Për sa i përket personelit gjëndja e personelit dhe e Muzeumit asht këjo:

1. Ndër 100000 volume vetëm 30000 janë regjistruar e katalogue, pjesa tjetër do të regjistrohet paralelisht me bamjen e raftave. Por që të procedojë me shpejtësi asht nevoja me shtue edhe një nëpunës e një kopiste. Këtu kemi nevojë për një nëpunës që të njohë sa do pakë gjuhët sllave për me regjistruar librat në sllavishte. Kopistja duhet të njohë sa do pakë nonji gjuhë të prendimit. Përgjithësisht tani këtu mbajmë 3 veta për regjistrimin dhe ç'do njeni në ditë mund të regjistrojë (të kopjojë: autorin, titullin, shënimet e komentet, përkëthimin eventual etj. , vëndin e botimit e datën, shtypshkronjën dhe edicionin) e t'i japë një numër deri 100 volume në ditë. Kopsitja që kemi tani, me gjithse punon shumë e mirë, nuk arrin të përballojë kopjimin e të gjitha skedave, të listave në hymje në dalje, të inventarëve të Muzeumit, dhe korrespondencën e zyrës. Kur ja kërkuem Ministrisë së Kulturës ajo na porositi të kërkojmë nga Kryeministria emnimin e Zonjës Violeta Nini, ish nëpunëse n'atë Ministri, si ma e përshtatshme për punën t'onë.

2. Pranë Bibliotekës figuron si rojtar nate Ferit Skënderi. Shërbimi i rojtarit të natës asht i pa-vlefshëm sepse nuk jep asnjë garanti kundër vjedhjeve, sidomos në rastin e Bibliotekës ku roja asht i plakun e flenë tërë natën dhe ndërtesa asht shumë e hapët e zhurmat e dhomave të fundit poshtë nuk digjohen fare. Prandej për roje do të duheshe të merrej nga Mbrojtja e Popullit për jashtë ku kemi të ekspozuem gurët e të tjera, dhe rojtari i ynë Ferit Skënderi të kthehet në shërbim ditën. Sidomos po të hapim Muzeumin poshtë asht e domosdoshme të mbajmë aty poshtë ditën një shërbëtor për të pasë kujdes që njerës të pashoqnuem të mos hyjnë ndër salla.

3. Sikurse i asht njoftue verbalisht dhe Z. Sekretar'i Përgjithshëm, dy kujdestarët Z. Gafur Bakllava dhe Kristofor

Baka si dhe shërbëtori Z. Avni Hasani tash një vjet janë ofrue vullnetarisht tuj punue raftet edhe jashtë orarit dhe i kanë kursue Shtetit 60000 fr. dhe po vazhdojnë gjithnjë të punojnë pa u kursye dhe pa marrë asnjë shpërblim. Për punën e tyne shëmbëlllore, si edhe për gjëndjen e mjerë familjare ata meritojnë t'u jepet një shpërblim i jashtëzakonshëm, me anë të cilit ata do t'a gjejnë të shpërblyem zellin e tyne, e do kuptojnë frymën e re që sundon sot n'administratën Shtetnore.

4. Shërbëtorja e pastrimit Z. Hatixhe Dema, tani që puna e Bibliotekës dhe e Muzeumit asht zgjanue nuk mund të kryejë e vetme pastrimin e lamjen e 24 dhomave e të dy koridorëve prej 30 m. të gjatë çdo njeri. Prandaj shërbimi saj asht i përciptë dhe shtyhet deri në orët vonë të paradrekës kur publiku ka mbushë sallat e leximit. Këjo punon vetëm paradreke me një shpërblim 500 fr. në muej. Edhe për pastrimin kemi nevojë të ngutëshme të shtojmë dhe një shërbëtorë tjetër, që të mundemi të shpëtojmë nga pluhuri, armiku kryesor i librave.

C. Përsa i përket anës financiare duhet theksue nevoja e një paradhënieje. Për një seri shpenzimesh të vogla si transport librash, blemje të rastësishme librash e gjanash për muzeum, shpenzime për libër-lidhësin etj., që shitësit nuk nuk pranpojnë t'i japin me mandatë se shumat janë tepër të vogla, na nevojitet herë pas here një paradhanje prej 2000 fr. Para një mujei Ministria e Financave n'akordoi një paradhanje të tillë, por me qenë se titullari i ma-parëshëm i kësaj Zyre Z. Aleks Buda nuk kish paraqitë ende faturat e paradhanjeve që kish marrë në emën te tij, mbetëm pa-përfutue dhe për këtë arsye nuk kemi mundë të barim në Bibliotekë p.sh. librat e Toçit, e të tjera. Në lidhje me këtë duhet të shënojmë edhe se Biblioteka disponon shumë arka vaj-guri e të tjera, sasina të mëdha librash si Shqipnija e Illustrueme, Shqipnija më 1937 etj., të cilat do t'ishte mirë të shiteshin, për të na u lirue edhe vendi që zanë.

D. Përsa i përket punës dhe perspektivave të Bibliotekës duhen shënuar këto:

1. Puna kryesore që do lypë një vjetë ose një vjet e gjysmë kohë asht ajo: me regjistruar dhe katalogue librat që kemi dhe objektet me vlerë të Muzeumit, sepse pa u krye këjo punë as nuk mund të dimë se ç'kemi, as nuk mund t'ekspozojmë Muzeumin dhe librat t'i vemë në përdorim të publikut.

2. Paralelisht me këtë punë, d.m.th. mbas 2-3 muejsh duhet të plotësojmë mbledhjen e librave që janë të shpërndamë dhe që i takojnë Bibliotekës si p.sh. librat e Toçit, ato të Egerem Vlorës, të Lef Nosit e të tjera dhe sidomos, sa të lirojmë disa salla poshtë që të marrim në dorëzim e të vendosim Bibliotekën e Muzeumin të jezuitëve të Shkodrës. Na asht raportue se Biblioteka e jezuitëve përmban afro 70.000 volume, prej të cilëve 10.000 albanologji dhe balkanologji me vlerë të madhe për vëndin t'onë.

3. Krahas me këta do të shkojë edhe bamja e katalogut metodik (damja e veprave si mbas landës) që kemi fillue tani dhe që lype dhe 5-6 muej punë për t'u vue në shërbim të lexuesve. Si dhe bamja e katalogut topografik (për çdo seri rafti)

në mënyrë që me mundë me kontrollue mungesat dhe humbjet eventuale.

4. Në Bibliotekë asht fillue dhe krijimi i një arkivës për ruejtjen e dorëshkrimeve dhe dokumentave të randësishëm për gjuhën dhe historinë t'onë, por natyrisht puna e seleksionimit, e vlerësimit dhe decifrimit të këtyne dokumentave e dorëshkrimeve do të jetë një gjë e ngadalëshme. Përsa i përket blemjes së librave mendojmë se asht mirë me ble jashtë në një kohë të ardhëshme veprat komplete të klasikëve të filozofisë e të letërsisë, si dhe veprat kryesore shkencore në 4 gjuhë të hueja: italisht, frëngjisht, gjermanisht e rusisht, sepse lexuesit nuk mund të përfitojnë nga libra në një gjuhë të vetme si ç'i kemi sot, dhe me koleksione të pa-plotësue.

6. Si përfundim duhet shtue, se Biblioteka ka nevojë për një pastrim gjithëmbarëshëm për të heqë një herë e mirë pluhurin që asht depozitue mbrënda në fletët e librave, dhe posa të rregullojmë dhomat sipër, d.th. mbas nja 2 muejsh, duhet t'a mbyllim Bibliotekën për nja 2 javë për lexuesit, dhe mundësisht 2 herë në vjet të bajmë një pastrim e dezinfektim të mirë.

#### Përfundim

Me plotësimin e nevojave që u përmendën sipër d.m.th. për një vjetë ose një vjet e gjysmë, Biblioteka e jonë Kombëtare do t'arrijë të bahet jo vetëm një nga Bibliotekat ma të mira të Ballkanit, por për disa specialitete si p.sh. Albanologji e Balkanologji do të krahasohet me Bibliotekat ma të mira t'Evrpoës edhe do të jetë një nder për Shqipninë e Re.

Vdekje Fashizmit - Liri Popullit

#### **DREJTOR' I BIBLIOTEKËS**

**Zef Mala**

**Firma (Vula)**

\*\*\*

Këtu poshtë po ju përcjellim dhe një listë të punimeve e të shpenzimeve ma të ngutëshme që nevojiten me doemos për Bibliotekën dhe Muzeumin.

Aneks

6 m3 drasa për 220 m2 rafta fr. shq. 12000

50 copë karrige për salla leximi " 5000 220 m. beze ose pëlhurë të randë për perde

Për 12 dritare 4 – 6 kapakësh fr. shq. 7000

3 rouleta për sallën e madhe poshtë " 3000

20 rafta për t'u vue kapak xhami për Muzeumin. fr. 3000

një dritare me hekura për 140 kg. " 1400 fr. shq. 31400

meremetime të vogla të pullazit t'ujit të dyerve e të tjera, fr. shq. 3600

shuma e përgj. fr. shq. 35000

AQSH F 511 v 1946 D 45"

Kjo shkresë është marrë në dorëzim nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, i cili shënon me inicialet A A më datë 2/4/ 946.

**Përgatiti për botim,  
Gjon Fierza**

# KANCERI I GJIRIT DISA SHENJA DHE SINJALE QE NUK DUHET TË LIHEN PAS DORE


Nga një vend në tjetrin -1 ne 8 gra rrezikojnë të zhvillojnë kancer gjiri gjate jetës. Gjetja e një mase (nyje) mund të jete tregues i kancerit të gjirit, por shumë shenja të tjera dhe sinjale alarmi mund të përjetohen shumë shpesh. Njihni shenjat, simptomat e kancerit të gjirit si:-Prezenca e një mase (kokrre-nyje) në gji. Kjo është një ndodhi e shpeshte, e cila ka karakteristika e veta si -kjo mase ka formën e dimensiononin vet gjate ciklit menstrual (periodave), por që duket e pa mundur që të ç vendoset ... kjo mase nuk ka ndjeshmëri në prekje dhe zakonisht nuk e është dhimbshme -kjo mase mund të ketë forma te ndryshme ne indin e gjirit. Çfarë është kanceri i gjirit?-Kanceri filon kur zhvillohen qeliza anormale dhe formojnë një nyje-tumor-në gji. Të rreth 90% të rasteve kjo nyje (tumor) zhvillohet në kanalet e qumështit (galactofere). E quajtura KARCINOMA kanalikulare ose në gjëndrën e gjirit-KARCINOMA lobulare, kur qelizat kanceroze mbeten në murin e kanaleve pa infiltrim flitet për carcinoma kanalikulare in situ (CCIS), në raste shumë të rralla kanceri zhvillohet në indin lidhor ose dhjamor kompozimi i të cilit mbetet në gji, kur vihet diagnoza tumor i gjirit sot klasifikohet sipas stadeve të zhvillimit:- nga 0i-zero-i pa avancuar ose pak i përparuar? Në stadin e 4 (IV) katërt me i avancuari sipas klasifikimit TNM (tumor, nod, metastaza), tregues ky për gravitetin, rëndesën e tumorit dhe të qelizave ose mbi proliferimin e qelizave maligne (të këqija) të tjera në organizëm.

-Prezenca-e një mase në axile (Squetull)-Nëse ju gjeni një mase (nyje), ose disa nyje dhe pse nuk është e forte në raport me indet për rreth -kjo mund të jete shenje e kancerit të gjirit. Këto masa shpesh janë të pa dhimbshme, por nganjëherë janë sensible. Prezenca e masave të vogla nëse janë të forta në aksile mund të tregojë se kanceri i gjirit është përhapur në gjëndrat limfatike. -Ndryshimi i madhësisë ose i formës së gjirit:- Një ndryshim i nivelit të madhësisë ose të formës përben shenje të kancerit të gjirit.

-Mos besoni mitet mbi kancerin e gjirit si pasoje e jetës se vështire e me telashe. Shumë njerëz mendojnë se kanceri është një beteje që të sëmuret mund ta fitojnë. Fatkeqësisht kjo nuk ndodh kështu, ky nuk është një armik i lehte. Ju duhet të jeni realist dhe veni qellim vetes për të ndryshuar mënyrën e jetesës. Progresi mund të ketë, të beje me objektiva të vegjël për gjendjen tuaj të shëndetit të përgjithshëm. Por mos u dorëzoni. Në re-

alitet- ka disa lloje kanceri të gjirit. Secili prej tyre ka një firmë molekulare unike dhe manifestime klinike të ndryshme. Në neuro-Onkologji të paktën janë identifikuar 120 nentipa kanceresh të trurit dhe të palces së kurrizit (medulla spinalis). Përball një armiku kaq të ndryshueshëm, ne duhet të zgjerojmë mbështetjen tone diagnostike dhe terapeutike-mjekues thekson Dott. ASHLEY Sumroll .

-Nëse ju jeni mbartës i "një gjeni kanceri" ju në të ardhmen do të keni kancer. Një numër personash mbartës të një mutacioni (transformimi) gjenetik, shoqërohen me rrezik të rritur, çfarëdo që të bëni



nuk mund ti fshiheni kësaj sëmundje. A ka diete, supra-ushqime që të mund ta parandalojnë ose ta shërojnë kancerin e gjirit? Disa njerëz mendojnë se, disa ushqime mund ta ulin rrezikun për këtë kancer, por nuk ka prova, është pak e besueshme që ushqimet e zakonshme të bëjnë diferencën-të ashtuquajturat "supra-ushqime"\*-fruta e perime me ngjyre, granula si proteinat e peshkut dhe të fasuleve-ne, këto mund të përdoren, por jo me idenë e parandalimit të këtij lloj kanceri. Megjithatë duhet të bëjmë një jete të shëndetshme

-Ndryshimet në lëkuren e gjirit:- Ndryshimet e lëkurës së gjirit në forme granulesh si lëkura e portokallit, me zgjerim ose lokalizim me vatra është shenje e kancerit të gjirit.

-Një mamele (thith) ose gji që kruhet mund të përbejë një shenje të kancerit inflamator, po ashtu skuqja, përshtypja e nxehtësisë, ose enjtja-duhet tu shqetësoj. Pra, mos i leni pas dore këto shenja, merrni seriozisht-si dhe ndryshimin e pozicionit mameles- tërheqja nga brenda, po

ashtu një dhimbje në pjesën e sipërme të shpinës, duhet të shqetësoheni për të bere një ECHO të gjirit. Pra, mos thellimi rrit rrezikun e kapjes me vonese të sëmundjes.

-Kullimi nga mamela mund të jete një shenje tjetër, sidomos kur ka presion mbi te. Pra, duhet të mos e leme tek simptomat e vona, të lëna pas dore-kur masa e tumorit përhapet në gji-ose del jashtë kufirit të gjirit, mund të ketë dhimbje koke, çrregullime shikimi, dobësi muskulare, dhimbje në kocka, tendenca për të vjella, rënie oreksi, rënie në peshe, zverdhje, zënie fryme deri kolle. Si të parandalojmë më mirë nga kanceri i gjirit Dott, Judith

zgjedhje e mirë. Evitoni yndyrat trans, si margarina, prodhimet e bulmetrave dhe të pastiçerish-lexoni etiketat, që të mos kenë vajra të homogjenizuara dhe as vaj misri, turnisol, të pasur me vajra të polisaturuara. Konsumoni ushqime të pasura me fibra-që lidhen me estrogenet dhe jashtëqitën me fece, me ane të zorëve, frutat e perimet bio, oriz, cerealet e të tjera, janë të dobishme lulalakra, brokoli, që mendohet se s' prodhojnë enzima antitumorale sipas disa autoreve, jepuni përparësi ushqimeve bruto. Merrni mish të freskët kafshësh dhe shpendësh pa hormone, lani perimet mirë me ujë të rrjedhshëm për të eliminuar pesticidet e ardhur nga spërkatjet. Qëndroni aktiv-sipas të dhënave kanceri i gjirit është 37% me i ulte tek grat, që bëjnë aktivitet fizik, apo bëjnë ecje në këmbë 45 minuta, 5 dite në jave, krahasuar me gratë sedentare (pa lëvizje), aktiviteti fizik ecje e të tjera qoftë dhe 2, 5 ore në jave e ul të paktën me 18% rrezikun e këtij kanceri. Duhet të kufizoni përdorimin e alkoolit, pasi dozat e mëdha rrisin nivelin e estrogeneve tërheq vëmendjen Kevin O, lhagai-(Irish Cancer society), sepse kufizojnë acidin folik dhe vitaminën A, që mbrojnë degjenerimin qelizor.

Merrni masa parandaluse-beni Echo dhe Mamografi -të cilat ua zbulojnë të paktën 2,5 vjet më herët, se sa të diktoni ndonjë shenje vete. Nëse jeni 50-69 vjeç-duhet të bëni çdo 2 vjet Echo gjiri. Personat me mamografi të dyshimta, duhet të kontrolloheni më shpesh-sido që ju vete bëni kontroll gjate dushit-se mos gjeni ndonjë kokërr (nod),

TRAJTIMET-duhet të behën pas konfirmimit të diagnozës me gjithë analizat dhe me biopsy, krahas TAC-rezonancës e të tjera. Por theksi vihet tek profilaksia dhe kapja në stadet sa më të hareshme. Për sa i takon mjekimit-llogaritjet mosha, gjendja e shëndetit të e përgjithshëm, madhësia e tumorit dhe qenia në menopauze, ose vlerësimi anatomopatologjik sipas vlerësimit---TNM (tumor, nod, metastaze), por mjeket janë familjarizuar me këtë problem, janë tepër të preokupuar për bere më të mirën që të jete e mundur për ju. Jeni të lutur mos pyetni për metoda primitive e mos vononi asnjë dite konsultimin me Onkologun, se do harxhoni kohë e shpenzime kot së koti, drejtojuni menjëherë mjekut të familjes, për të shkuar tek ONKOLOGU

Përgatiti Dr. Med. Ndue Nikaj,  
Pthathog Internist Shkodër, maj 2021

## REDAKSIA

Kryeredaktore: LUIGJ SHYTI

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi Botimin:  
**PREKË GJONAJ  
SOKOL STËRBYQI  
KANADA**